

	RAPORT VJETOR 2021	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 1 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
OPERATOR SISTEMA PRENOŠA I TRŽIŠTA KOSTT d.d.

Nr. 641 Dt. 30 03 2022  
PRISHTINË-A



# Raport Vjetor 2021

## Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a

Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e 131/22 të datës 28 mars 2022 miratoi Raportin Vjetor për vitin 2021

### Vendimi 220328-II/4

Bordi i Drejtoreve në bazë të Nenit 31.3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Nenit të 14.2.2.11.2 të Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT, njëzëri dhe me vërejtjet e dhëna miratoi Raportin Vjetor për vitin 2021.

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Kadri Kadriu -u.d.Kryeshef Ekzekutiv	Bordi i Drejtoreve Veton Mehmeti - Kryesues i BD
Nënshkrimi			
Data	Shkurt, 2022	Shkurt, 2022	Mars, 2022



## Permbajtja;

Lista e shkurtesave .....	6
1. Hyrje .....	9
1.1. Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT .....	10
1.2. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a .....	11
1.3. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2021.....	13
1.4. Makro Struktura organizative e KOSTT .....	14
2. Raporti i Bordit të Drejtorëve.....	15
2.1. Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2021 .....	15
2.2. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv.....	16
3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv.....	18
3.1. Arritjet kryesore .....	18
3.2. Ngjarjet kryesore të vitit.....	24
4. Operimi i Sistemit .....	32
4.1. Marrëveshja e Kyçjes (Connection Agreement) KOSTT – ENTSO-E.....	32
4.2. Funksionalizimi i Bllokut të Kontrollit (Control Block) AK – procedurat.....	32
4.3. Krijimi dhe dërgimi i fajllave DACF (Day Ahead Control Files) në Swissgrid.....	32
4.4. Kalkulimi i Net Transfere Capacities (NTC).....	33
<b>4.5. Publikimi i të dhënave në Platformën e Transparencën në ENTSO-E.....</b>	<b>34</b>
<b>4.6. Instalimi i pajisjeve MDC për monitorim të rrjedhave të energjisë - çdo 1 sek.</b> .....	<b>35</b>
4.7. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances .....	36
4.7.1. Bilanci i planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2021 .....	36
4.8. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit.....	40
5. Operimi i Transmisionit .....	41
5.1. Rrjeti transmetues aktual i Kosovës .....	41
5.2. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit.....	43
6. Operimi i tregut .....	46

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 3 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

6.1. Madhësia e Tregut.....	46
6.2. Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues.....	47
<b>6.3. Fondi BRE (Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë elektrike) .....</b>	<b>51</b>
7. Pasqyra e performances financiare dhe Rezultatet .....	53
7.1. Pasqyra e Pozicionit Financiar .....	53
7.2. Pasqyra e të ardhurave .....	54
7.3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	55
7.4. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë .....	56
7.5. Analiza e IKP-ve financiare .....	57
7.6. Progresi me planin e Biznesit .....	59
8. Realizimi I Projekteve Kryesore Kapitale Gjatë Vtit 2021.....	68
8.1. Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	77
8.1.1. Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen: .....	79
8.1.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit .....	80
8.2. Sfidat e KOSTT .....	81
8.3. Aktivitetet tjera .....	83
9. Rreziqet .....	84
9.1. Sponsorimet dhe donacionet .....	85
10. Raporti i Auditorit të Brendshëm .....	85
11. Burimet njerezore .....	91
11.1. Politika e personelit në KOSTT .....	91
11.1.1. Struktura kualifikuese.....	92
11.2. Numri i punëtorëve .....	92
12. Përbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore .....	100
13. Kontratat/transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2021 nga burimet e KOSTT .....	156
14. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës.....	170

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	fazë 4 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Tabela;

Tabela 1	Vendimet e Bordit për aprovin e dokumenteve .....	17
Tabela 2	Aktivitetet për harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale .....	22
Tabela 3	Vleresimi I NTC .....	33
Tabela 4	Bilanci i Energjisë Elektrike të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2021 .....	37
Tabela 5	Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit.....	41
Tabela 6	Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit.....	45
Tabela 7	Prodhimi nga BRE pjesëmarrës në Skemën Mbështetëse .....	52
Tabela 8	Pasqyra e Pozicionit Financa .....	53
Tabela 9	Pasqyra e të Ardhurave .....	54
Tabela 10	Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	55
Tabela 11	Paqyra e Rrjedhës së Parasë .....	56
Tabela 12	Analiza e IKP-ve financiare .....	57
Tabela 13	Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2021.....	75
Tabela 14	Departamentet, zyrat e audituara dhe numri i rekomandimeve.....	88
Tabela 15	Gjendja e implementimit të rekomandimeve për vitin 2021 .....	90
Tabela 16	Lëvizja e punëtorëve gjatë vitit 2021 .....	93
Tabela 16	Punëtorët sipas profesionit 2021 .....	97
Tabela 17	Lendet gjyqesore .....	155
Tabela 18	Kontratat/Transaksionet gjatë vitit 2021 nga burimet e KOSTT .....	168

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 5 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Lista e figurave;

Figura 1	Makro Struktura organizative .....	14
Figura 2	Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2021.....	19
Figura 3	Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2021.....	20
Figura 4	<a href="https://www.seecao.com/">https://www.seecao.com/</a> .....	34
Figura 5	<a href="https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show">https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show</a> .....	35
Figura 6	Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2021.....	38
Figura 7	Bilanci i realizuar i energjisë elektrike ne GWh Janar-Dhjetor 2021 .....	39
Figura 8	Të dhënrat themelore energjetike.....	46
Figura 9	Tregu i rregulluar dhe pa rregulluar .....	47
Figura 10	Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë .....	49
Figura 11	Pjesëmarrja e blerjes së humbjeve nga KEK dhe Ankandi.....	50
Figura 12	Pjesëmarrja e blerjeve të energjisë nga ana e KOSTT për vitin 2021 .....	50
Figura 13	Implementimi i projekteve si dhe ato ne pritje.....	76
Figura 14	Planifikimi dhe realizimi i auditimeve gjatë vitit 2021 .....	87
Figura 15	Treguesit e auditimeve / rekomandimeve, për periudhën 2018 -2021 .....	88
Figura 16	Treguesit e rekomandimeve për vitin 2021 .....	89
Figura 17	Treguesit e rekomandimeve për vitin 2021 .....	94
Figura 18	Punëtorët e pranuar dhe të pensionuar.....	94
Figura 19	Numri i punetoreve sipas departamenteve dhe gjinise .....	95
Figura 20	Grupimi i punëtorëve sipas kualifikimit.....	96
Figura 21	Punëtorët sipas grup moshave .....	98
Figura 22	Punëtorët sipas lokacionit .....	99

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 6 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## **Lista e shkurtesave**

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshmëri Mesatar (Import/Eksport)

AC-DC – Shpenzimet veta nake

ACE – Area Control Error (Gabimi zones rregulluese)

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

AK LFC - Blloku Kosove- Shqiperi per rregullim te frekeunes

aFRR- Automatic Frequency restoration Reserves (Rregullimi automatik I frekuences)

ATC – (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshmëri

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BRE- Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

CAO – (Capacity Allocation Office) – Zyra e Alkoimit të Kapaciteteve

CGES- (Crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

CGM\OPDE (common grid model/ operational planning data environment) - Modeli i rrjetit të bashkuar/ infrastruktura për grumbullimin e të dhënavëve për planifikimin operativ

CM – (Congestion Management)- Menaxhimi i kongjestioneve

DACF - Day Ahead Contingency Files-Parashikimi i Kongjestionit (shtrëngesave në sistem) një ditë para

EAS (energy awarness system) - Sistemi për vetëdijesimin me situatën energjetike

EJL – Evropa Juglindore

EMI – (Electricity Market Iniciative)– Nisma për Tregun e Energjisë Elektrike

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pa furnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

FSkar (Financial settlement of kΔf, ACE and ramping period)- Barazimi Financiar për Frekuencën Stabilizuese

HC - Hidrocentral

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 7 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

IPA- Instrumentet para anëtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmetimit)

KA – Konflikt Administrativ

KAEF – (Kosovar American Education Fund) – Fondi Kosovar Amerikan për Arsim

KEK – Korporata Energetike e Kosovës

KESCO - (Kosovo Electricity Supply Company)- Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LEE – Ligji për Energjinë Elektrike

LFC Zonë – Load Frequency Control

LP – Largpërçuesi

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MBE – Marrëveshja për Blerjen e Energjisë

mFRR - Rezerva Manuale për Restaurimin e Frekuencës

MEPSO (Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator) – Operatori i sistemit dhe transmetimit të Maqedonisë

MSA – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

MEA – Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPC (Outage Planning Coordination) - Planifikimi i Çkyçjeve të Koordinuara

OPGW – fibri optik

OS – Operatori i Sistemit

OST – Operator i Sistemit të Transmetimit

OT – Operatori i Transmetimit

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmetimit

PShK – Përgjegjësia Shoqërore Korporative

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 8 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

RSCI – (Regional Security Coordination Initiative) – Iniciativa për koordinim të sigurisë rajonale)

RGCE - Grupi Regional i Evropës Kontinentale

SAFA- Synchronous Area Framework Agreement (Marrevëshja kornizë e zonës Sinkrone)

SCADA /EMS-System Control and Data Acquisition/Energy Management System (Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë)

SKE – Sekretariati i Komitetit të Energjisë

SCC (Security critical coordination) - Kordinimi i sigurisë kritike

SEE – Sistemi Elektro Energetik

SMTA – (Short- &Medium-Term Generation Adequacy) - Adekuacia afatshkurtër dhe afatmesme e gjenerimit

SSH - Stacioni Shperndares

SOGL- System Operation Guidline (Udhezuesi I operimit te sistemit)

TC A – Termocentrali Kosova A

TC B – Termocentrali Kosova B

TE- (Transmited energy)- Energjia e transmetuar

TI K– Teknologja e Informacionit dhe Komunikimi

TMR – Transformatori matës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (United States Agency for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

ZRrE – Zyra e Rregulatorit të Energjisë

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 9 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 1. Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2021 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Raporti është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2021 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 10 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 1.1. Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT

Viti që lamë pas, përvèç ndikimit të pandemisë Covid 19, është karakterizuar edhe me rritje të çmimit të energjisë në tregun global i cili ka pas përsosje krisjen energjetike të shpallur në vend.

Ky vit për KOSTT-in shënohet me fillim të mbarë, me Operimin e Sistemit të Transmetimit, në kushte të reja të operimit, KOSTT zonë rregulluese në bllokun AK, ku Operimi në përpunje me rregullat e ENTSO-E dhe me Udhëzuesin për operimin e sistemit, ka dëshmuar se falë punës së vazhdueshme profesionale janë evidente të arriturat të cilat bëjnë që KOSTT të vlerësohet për performancë si në aspektin e funksionimit teknik ashtu edhe për balancimin e sistemit të Kosovës (me përjashtim të devijimeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës).

Duke pas parasysh rëndësinë e Marrëveshjes KOSTT ENTSO-E në nivel vendi, implementimi i kësaj marrëveshje përbën prioritet të veçantë për KOSTT deri në anëtarësimin e plotë të KOSTT në ENTSO-E.

Gjatë këtij viti KOSTT ka shënuar manifestimin e 15 vjetorit të themelimit ku shpalosen të arriturat ndër vite të KOSTT përmes së cilave KOSTT ka arritur zhvillimin, me theks të posaçëm punonjësit e saj pa të cilët këto të arritura nuk do të ishin të mundshme.

Sfidë e madhe përkundër krisës energjetike, për KOSTT mbetet mungesa e mbulimit të humbjeve/konsumit për pjesën veriore të Kosovës ku përgjegjësia e pa-adresuar brenda Kosovës, si rezultat i vendimeve gjyqësore, mbetet e patrajtuar dhe mbetet barrë e madhe për ne.

Performanca pozitive e KOSTT, vazhdoi edhe gjatë vitit 2021, pavarësisht sfidave të shumta dhe përballjes me krisjen energjetike, me përjashtim të çështjes së pazgjidhur sa i përket obligimeve të humbjeve të energjisë elektrike në Veri të Kosovës, zhvillim ky jashtë kontrollit të KOSTT, por i cili në aspektin financier ka pasur një impakt të lartë duke e vënë KOSTT në situatë të vështirë financiare.

Ne si Bordi i Drejtorëve jemi të përkushtuar për zhvillimin e mëtejmë të KOSTT, gjithnjë duke pasur parasysh se zhvillimit të sistemit i paraprinë zhvillimi dhe motivimi i punonjësve të saj. Bordi i Drejtorëve mbetet i zotuar dhe fuqishëm beson se sukseset e KOSTT nuk do të mungojnë as në vitin 2022 dhe shpreh mirënjojen për të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin e KOSTT sh.a.

Sinqerisht i juaji,

Jeton Mehmeti

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



## 1.2. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a

Të nderuar përfaqësues të aksionarit,

Të nderuar/a palë të interesit,

Vitin 2021, KOSTT e filloi si asnjëherë më parë në historinë e Sistemit Elektroenergetik të Kosovës, duke operuar dhe menaxhuar me sukses e me përgjegjësi të plotë Sistemin e Transmetimit të Kosovës, tanë të pavarur dhe të integruar në Bllokun rregullues Shqipëri-Kosovë, pjesë e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

Në këtë vit, ne gjithashtu shënuam 15 vjetorin e themelimit të kompanisë, vite të karakterizuara me sukses e me sfida, por padyshim të karakterizuara me përkushtimin maksimal për arritjen e objektivave zhillimore të KOSTT në të mirë të avansimit dhe të integrimit të sektorit të energjisë së vendit tonë.

Rezultatet e theksuara që janë arritur përgjatë këtyre 15 viteve, dëshmojnë aftësinë e KOSTT për të përmbushur objektivat e përcaktuara strategjike duke krijuar vlerë të qëndrueshme për aksionarin.

Investimet e vazhdueshme që nga themelimi për zhvillimin dhe avansimin e Sistemit të Transmetimit të Kosovës kanë rezultuar me arritjen e shkallës së lartë të sigurisë dhe besueshmërisë në ofrimin e shërbimeve për palët e kyçura në sistem. Për 15 vite të operimit, kapacitetet bartëse të rrjetit të transmetimit janë dyfishuar duke mundësuar kështu menaxhimin e rekordeve të reja të ngarkesës në rrjet pa asnjë problem. Në vitin 2021 u shënua rekordi i ri i ngarkesës me datë 21 dhjetor 2021 në ora 23:00, në vlerë prej 1403 MW energji elektrike. Numri i nënstacioneve të KOSTT është rritur për 27% ndërsa rrjeti i linjave të tensionit të lartë në vend është zgjeruar për 35% që nga themelimi.

Në mbështetje të sigurisë së furnizimit, gjatë vitit 2021 është punuar në vazhdimësi me partnerin strategjik, Qeverinë Gjermane përmes KfW, në marrëveshjen për pakon e re të projekteve zhillimore, e cila tashmë mori edhe mbështetjen e Qeverisë së Kosovës.

Në anën tjetër, në vijimësi të partneritetit të qëndrueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe USAID, është shenuar avansim i theksuar edhe në zhvillimin e mëtujeshëm dhe integrimin e tregut të energjisë. Në këtë drejtim, në tetor të vitit 2021 u nënshkrua marrëveshja mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë përmes së cilës jemi përafruar edhe më tutje në rrugëtimin për operacionalizimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) e cila planifikohet të filloj operimin në vitin 2022.

Në kuadër të përkushtimit tonë për mbështetjen e procesit të dekarbonizimit të sektorit energetik, kemi vazhduar me shqyrtimin e kërkesave të reja për integrim të BRE-ve në rrjetin e transmetimit.

Kriza globale energetike në vitin 2021 ka perfshire edhe Kosoven qe u ballafaqua me një situatë të jashtëzakonshme të krizës energetike si rezultat i rritjes se çmimeve te energjise elektrike ne treg. Duke i shtuar kësaj edhe situatën e pazgjidhur të çështjes së veriut të Kosovës, ku KOSTT ende mban obligimin e mbulimit të humbjeve nga energjia e konsumuar dhe e papaguar në atë pjesë të vendit, në fund të vitit kanë sjellur KOSTT-in në një situatë me të vështirë që nga themelimi i saj nga aspekti financiar i kompanisë. Gjithashtu keto ngjarje kane ndikuar negativisht ne vazhdimin e zhvillimeve te projekteve kapitale ne fund te vitit 2021.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 12 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Në periudhën e krizës së energjisë vlen për t'u theksuar roli i rëndësishëm që ka luajtur KOSTT si në stabilitetin e rrjetit të brendshëm ashtu edhe në ruajtjen e integritetit të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës karshi atij Evropian.

Përkundër sfidave të theksuara, KOSTT është kompania e parë publike në Kosovë e certifikuar me standardin ndërkombëtar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2013. Ndërkaq, mbetemi të fokusuar në angazhimet tona për sigurinë kibernetike si faktor i rëndësishëm në industrinë e energjisë globalisht.

Ne gjithashtu kemi vazhduar që të japim ekspertizën tonë në grupet punuese në nivel vendi dhe e konsiderojmë privilegj mundësinë që e kemi për të shërbyer në të mirë të sektorit të energjisë.

KOSTT tashmë ka rritur një shkallë të theksuar të zhvillimit dhe hapat tanë të mëtujeshëm janë të fokusuar në implementimin e masave teknike të nevojshme për të nënshkruar Marrëveshjen e Përherershme të anëtarësimit të plotë në ENTSO-E.

Ne jemi krenar me të arriturat e KOSTT deri më tani, me zhvillimin dhe me stafin profesional që gjithherë jasin më të mirën në rrugëtimin e KOSTT.

Duke falënderuar të gjitha palët e interesit dhe partnerët tanë strategjik për mbështetjen e vazhdueshme dhe besimin që kanë treguar ndaj KOSTT ndër vite, ne mbetemi të vendosur për të punuar për të ardhmen prosperuese të KOSTT dhe të sektorit të energjisë në përgjithësi.

Ju ftoj që përmes Raportit Vjetor të elaboruar në vijim, të njoftoheni më detajisht me aktivitetet që ka ndërmarrë KOSTT në funksion të përmbushjes së misionit të saj, me përkushtimin e vazhdueshëm për të arritur impakt pozitiv në të gjitha fushat e aktiviteteve të saj.

Sinqerisht,

Kadri Kadriu

u.d Kryeshef Ekzekutiv

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 13 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

### 1.3. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2021

Më 25 prill 2018, Bordi i Drejtoreve të KOSTT-it në mbledhjen nr.103/18, ka aprovuar Riorganizimin e brendshëm të KOSTT, përkatësisht makro skemën organizative.

Ndryshimet janë reflektuar në shumicën e departamenteve, zyrate dhe sektorëve brenda në departamente. Ndryshimet në harmoni me vendimet e Bordit të Drejtoreve dhe Kryeshefit Ekzekutiv janë implementuar nga 01.05.2018 dhe shihen në Makro Skemën Organizative të KOSTT.

Sipas kësaj strukture, menaxhmenti më i lartë i KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Auditori i Brendshëm dhe Drejtoret e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmetimit;
- Operatori i Tregut;
- Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve;
- Çështjet Rregullative dhe Tarifa;
- Financat dhe Thesari;
- Burimet Njerëzore;
- Shërbimet Përkrashëse
- Prokurimi;

Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyrën Ligjore dhe Menaxheri për Cilësi dhe Politika.

Në kuadër të riorganizimit të fundit është shtuar edhe një vlerë e re në makro –strukturë si KOSTT Consulting. Për funksionalizimin e KOSTT Consulting janë zhvilluar aktivitetet e para në lidhje me definimin e kornizës përmbajtjesore për të, në bashkëpunim me Repower (USAID).

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:

- Zhvillimi i sistemit të Transmetimit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë;

- Nevoja për zhvillim të stafit dhe për zhvillim të infrastrukturës si rrjedhojë e integrimeve në institucionet ndërkombëtare Evropiane dhe rajonale, si dhe ndryshimeve dhe zhvillimeve në tregun e energjisë elektrike.
- Hyrja e KOSTT-it në tregun e telekomunikimeve të Kosovës dhe në tregun e telekomunikimeve dhe integrimin me vendet e rajonit, duke filluar iniciativën me OST-të fqinje (nga Banka Botërore ka filluar interesimi për të mbështet fillimin e një projekti për ndarjen e infrastrukturës ndërkufitar të telekomunikacionit respektivisht të fibrave optik), me ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

#### **1.4. Makro Struktura organizative e KOSTT**




Figura 1

Makro Struktura organizative

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 15 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 2. Raporti i Bordit të Drejtorëve

### 2.1. Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2021

Bordi i Drejtorëve të KOSTT i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publik dhe Ligjin për Energjinë Elektrike gjatë vitit 2021 ka qenë në këtë përbërje:

- Jeton Mehmeti (Kryesues)
- Arben Dodaj, Anëtar
- Nebih Zariqi, Anëtar
- Znj. Ajrina Gashi Hamdiu, Anëtare
- Znj. Xhyldane Kiçmari, Anëtare

Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin Nr.08-V-063 me datë 12.08.2021 ka liruar nga detyra znj. Xhyldane Kiçmari nga pozita e anëtares së Bordit të NP KOSTT Sh.a. Pas kësaj date, për periudhën në vijim të vitit 2021 Bordi i Drejtorëve i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë në përbërje prej katër (4) anëtarëve të cekur si më lartë.

Bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike Kryeshefi Ekzekutiv është anëtar i Bordit të Drejtorëve sipas detyrës zyrtare.

Gjatë vitit 2021 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta, 5 mbledhje të jashtëzakonshme si dhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin e cila është mbajtuar në afatin e paraparë ligjor.

Gjatë vitit 2021 Komisioni i Auditimit nuk ka qenë funksional për arsy se Bordi i Drejtorëve nuk ka qenë në përbërje të plotë.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha çështjet e parapara me planin e punës së Bordit të Drejtorëve të cilat hyn në kuadër të obligimeve ligjore, si dhe në kuadër të përgjegjësive të veta ka miratuar politika, raporte dhe procedura përkatëse.

Përveç çështjeve dhe aktivitetave të lartëshënuara, Bordi i Drejtorëve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për Ndërmarrjeve Publike, në vazhdimësi ka shqyrtuar performancën e KOSTT dhe ka qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit.



## 2.2. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2021 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërjen vijuese:

- z. Jeton Mehmeti, Kryesues i Bordit, me profesion ekonomist
- z. Arben Dodaj, Drejtor i Bordit, me profesion ekonomist
- z. Nebih Zariqi, Drejtor i Bordit, me profesion inxhinier
- z. Ajrina Gashi - Hamdiu, Drejtore e Bordit, me profesion ekonomiste
- z. Xhyldane Kiçmari, Drejtore e Bordit me profesion ekonomiste (Drejtore Bordi deri me datë 12.08.2021)

Kompensimi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it është bërë bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës me nr.05-V-389 të datës 01.12.2016. Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2021 ka realizuar një udhëtim zyrtar dhe nuk ka pas kompensime të tjera si mëditje apo bonuse.

Në vazhdim janë paraqitur Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si në vijim:

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Plani i punës për Bordin e Drejtorëve për vitin 2021
2	Raporti për tremujorin e katërt 2020 (TM4 2020)
3	Elaborati i regjistrimit vjetor të pasurisë së KOSTT për vitin 2020
4	Politika për udhëtime zyrtare
5	Politika mbi ngacmimet seksuale në vendin e punës
6	Kërkesa për ndarjen e buxhetit për "Rialokimin e transformatorëve energjetik"
7	Miratimi i kërkesës për ndarjen buxhetore për përkrahje të Fondit Kosovar Amerikan për Edukim
8	Raporti vjetor për vitin 2020
9	Raporti për kënaqësinë e konsumatorit për vitin 2020
10	Raporti për auditim të jashtëm për auditim të pasqyrave financiare viti 2020
11	Miratimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për devijimet e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021 bazuar në Rekomandimet Nr.08-R-01 të dt.06.05.2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 17 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

12	Raporti për tremujorin e parë 2021 (TM1 2021)
13	Formulari i vet vlerësimit të efektshmërisë
14	Vendim për ndarjen e mjeteve në mbështetje financiare për punëtorë të KOSTT
15	Raporti për tremujorin e dytë 2021 (TM2 2021)
16	Propozimin për shitjen e skrapit
17	Miratimi i kërkesës për Lirimin nga detyra të Kryeshefit Ekzekutiv z. Mustafë Hasani dhe sistemimi i tij në një pozitë pune bazuar në kontratën e punës dhe ligjet në fuqi
18	Emërimi i z. Kadri Kadri ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv
19	Miratimi i kërkesës së aksionarit për deklarimin e dividendës nga KOSTT në shumë prej 20,000.000.00 euro dhe autorizoi shërbimet profesionale të bëjnë transferimin e mjeteve në llogarinë kryesore të thesari të Republikës së Kosovës
20	Miratimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për devijimet e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021 bazuar në Rekomandimet Nr.08-R-01 të dt.06.05.2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës
21	Plani i Biznesit i Rishikuar për vitin 2021
22	Buxheti i Rishikuar për vitin 2021
23	Plani i Biznesit për vitin 2022
24	Buxheti i Planifikuar për vitin 2022
25	Raporti për tremujorin e tretë viti 2021 (TM3 2021)
26	Vendim për térheqjen e ankesës në Gjykatën e Apelit të Kosovës në lëndën A.nr.2143/17 të dt..29.09.2020 Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, me Paditës KOSTT sh.a. dhe të paditur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës
27	Miratimi i Draft Marrëveshjes për kredi me KFW dhe autorizimi i u.d. Kryeshefit Ekzekutiv për nënshkrim të marrëveshjes
28	Politika për Nivelin e Autorizimeve në KOSTT
29	Miratimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për devijimet e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës për vitin 2021 bazuar në Rekomandimet Nr.08-R-01 të dt.06.05.2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Tabela 1 Vendimet e Bordit për aprovin e dokumenteve



### 3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

#### 3.1. Arritjet kryesore

Përpjekjet e KOSTT-it qysh nga themelimi, ishin dhe do të janë edhe në të ardhmen, të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike, të cilat janë në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin e KOSTT. Duke u bazuar në të gjitha këto, edhe gjatë vitit 2021 përkundër vështirësive të mëdha që kanë ndodhur si rezultat i krizës energetike në vend si pasojë e krizës energetike në Evropë, KOSTT ka vazhduar trendin e saj të performimit pozitiv, duke dëshmuar kështu se mbetet edhe më tutje një organizatë e qëndrueshme dhe efektive.

KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, dhe tani është duke u përgatitur për sfidat e reja me të cilat do të përballet në të ardhmen.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar me sukses operimi i KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale si pjesë e bllokut Kosovë- Shqipëri respektivisht blloku AK.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar të ketë kërkesa për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve të reja dhe rehabilituese të rrjetit të transmetimit, si dhe për mirëmbajtje të planifikuar. Përkundër rrethanave të vështirësuar shkaku i pandemisë Covid 19, janë organizuar punët për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Disa prej këtyre kërkesave janë përcjellë me domosdonë e shkyçjeve të objekteve elektro energetike, me ç ‘rast është zvogëluar siguria e furnizimit të pandërprerë. Në rastet e tillë janë bërë të gjitha përgatitjet gjatë fazës planifikuese dhe në kohë reale për operim të sistemit sa më të besueshëm, duke bërë koordinimin e gjithmbarshëm të këtyre shkyçjeve në aspektin brenda Kosovës si dhe në nivel rajonal. Përkundër këtyre rrethanave gjatë vitit 2021 është arritur që të mirëmbahet siguria e furnizimit dhe që kohëzgjatja e mos furnizimit të jetë e kontrollueshme.

Në mesin e detyrave të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, një nga detyrat kryesore mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, KOSTT ka vazhduar trendin e performimit pozitiv, edhe gjatë vitit 2021.

KOSTT ka arritur që të garantoj një siguri të lartë të operimit dhe mund të thuhet se performanca e arritur është mjaft e kënaqshme. Këtë e dëshmon numri i rënieve dhe intervenimeve, të cilat nga viti në vit kanë qenë në rënje dhe tani është arritur që të minimizohet numri i tyre.

Njëkohësisht, që të sigurohet operim i sistemit sa më efikas, është duke u vazhduar me investimet në rehabilitimin e nënstacioneve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre.


Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit

dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizonin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë këtij viti është realizuar 98% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 99% e mirëmbajtjes së Qarqeve Primare, 97% i Qarqeve Sekondare dhe 87% i Mbrojtjeve Rele, si dhe janë zhvilluar aktivitetet e tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergjetik.

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, shfrytëzohet Rregullorja e Mirëmbajtjes e cila për bazë ka metodologjitet më të avancuara të qasjes në stabilimente duke marrë parasysh teknologjinë e përdorur si dhe afatet e duhura kohore për mirëmbajtje dhe shqyrtime të pajisjeve elektrike. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet e mirëmbajtjes në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Në vazhdim, është paraqitur disponueshmëria e linjave dhe nënstacioneve në SEE gjatë vitit 2021:






Figura 3

Disponueshmëria totale e linjave gjatë vitit 2021

Gjatë tërë vitit 2021 ka vazhduar puna e grupeve punuese KOSTT-OST për të mundësuar implementimin e Marrëveshjes së Bllokut Rregullues të Sistemeve Energetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK). Kjo marrëveshje obligon palët (KOSTT dhe OST) të punojnë bashkërisht në operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja SAFA dhe SOGL si dhe në harmoni me kodet nacionale të rrjetit.

Ky grup punues ka punuar duke i marrë parasysh kërkesat për operimin e LFC të bllokut në dy LFC zona, funksionimin e aFRR sipas marrëveshjes (Marrëveshja e Shkëmbimit të rezervës automatike ndërmjet KOSTT dhe OST) si dhe duke analizuar mundësinë e përfshirjes së funksionit Imbalance Netting në kuadër të rregullimit automatik.

Për të realizuar zbatimin e Marrëveshjes së Bllokut AK, sipas detyrave të përcaktuara për grupet përkatëse, në koordinim të plotë me përfaqësuesit e grupit të OST, është realizuar shkëmbimi i të dhënave për monitorimin e Bllokut në kohë reale për qëllim të monitorimit të ACE. Janë realizuar testimet e funksionimit softuerik të përkrahjes së aFRR me OST, test procedura (pa veprime kthyese në rrjet të fuqisë) e përkrahjes së aFRR si qëllim i vërtetimit të punës së komunikimit, dhe pajisjeve që ndodhen në mes KOSTT dhe OST, gjë që kanë rezultuar të suksesshme.

Në vitin 2022 do të bëhet adaptimi i sistemit të kontrollit të sistemit në NS Rahoveci, NS Palaj dhe NS Gjakova 2. Afati i realizimit të këtyre projekteve është 18 muaj. Ky process do të vazhdoj edhe në disa nëntsacione tjera.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021. Viti është përmbyllur pa asnjë incident, lëndim të punëtorëve apo emergjencë mjedisore.



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 21 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Viti 2021 nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve ka qenë një sfidë në vete për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga korona virusi Covid-19. Përkundër situatës së krijuar nga pandemja, është arritur me sukses që të menaxhohet përhapja e infeksionit nga Covid-19 dhe ruajtja e shëndetit të punëtorëve. Të gjitha veprimet dhe masat mbrojtëse janë implementuar në përputhje me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK). Ndër masat mbrojtëse që janë ndërmarrë, kanë qenë: informimi i vazhdueshëm i punëtorëve, dezinfektimi i hapësirave të punës, furnizimi me maska mbrojtëse dhe dezinfektues për duar, mbajtja e distancës dhe reduktimi i stafit në vendet e punës, pa penguar aktivitetet esenciale të KOSTT për të mbajtur besueshmërinë e Sistemit të Transmetimit përfurnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga korona virusi Covid-19, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar më pak inspekte të terren dhe kontakte të drejtpërdrejta me punëtorë.

Pandemja në nivel global ka ndikuar edhe në pezullimin e organizimit të trajnimeve, punëtorive dhe konferencave të ndryshme, duke ndikuar drejtpërdrejtë edhe në implementimin e planit të trajnimeve.

Opioni i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare përvitin 2020 është pa asnjë kualifikim, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Ndryshimi i kornizës rregullative nga Zyra e Rregulatorit përfundit një tregu konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe krijimit të kushteve për qasje jo diskriminuese dhe transparente ndaj palëve të treta, ka rezultuar në ndërmarrjen e aktiviteteve nga KOSTT përfundit harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale të brendshme kundrejt dispozitave bazë të nxjerra nga institucionet e lartekura.

Në kuadër të kësaj, KOSTT ka ndërmarr aktivitetet vijuese:

**RAPORT VJETOR 2021**

ver. 1.0

**DT-FI-010**

faqe 22 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Nr.	Dokumenti	Qëllimi	Vendimi nga ZRrE
1.	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1422_2021
2.	Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimit të sistemit dhe tregut (KOSTT Sh. A.)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1436_2021
3.	Metodologjia për Vlerësimin e NTC në Linjat Interkonektive	Në pajtim me Ligjin për Energjinë	V_1427_2021
4.	Propozimi i TSO-ve Kontinentale Evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e paqëllimshme	Në pajtim me Synchronous Area Framework Agreement (SAFA)	V_1425_2021
5.	Propozimi i TSO-ve Kontinentale Evropiane për Rregullat e përbashkëta të barazimit përfundimtar për shkëmbimet e qëllimshme	Në pajtim me Synchronous Area Framework Agreement (SAFA)	V_1426_2021
6.	Kërkesa për Derogim për përgatitjen e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike 2022 – 2031 dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit 2022 – 2031.	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit	V_1369_2021

Tabela 2 Aktivitetet për harmonizimin dhe krijimin e kornizës rregullative funksionale

Në ndërlidhje me planet e rregulla të punës, KOSTT ka realizuar monitorimin e brendshëm të implementimit të Kodit të Rrjetit për vitin 2021, duke bërë gjithashtu edhe rishikimin e dokumenteve varësisht prej kërkesave ligjore dhe konkluzioneve të nxjerra nga ky aktivitet. Duke u mbështetur në dispozitat nga Ligji për Energjinë Elektrike, raporti final i Monitorimit të Implementimit të Kodit të Rrjetit për vitin 2020 është dërguar në ZRrE.

Në kuadër të procesit të implementimit të kornizës rregullative të sektorit të energjisë që ndërlidhet me procesin e Integrimeve Evropiane, KOSTT vazhdimesht ka qenë dhe është pjesë e procesit të raportimit mbi implementimin e masave ligjore dhe zbatuese të përfshira brenda Agjendës Evropiane për Integrim dhe Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (PKZMSA) duke mos anashkaluar edhe Planin e Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës (PVPQ) si pjesë ndërlidhëse me këtë proces integrues.



Sipas kërkesave nga legjislacioni primar dhe nga legjislacioni sekondar, sipas afateve të përcaktuara nga ZRrE, KOSTT ka përgatitë dhe ka dërguar në ZRrE dokumentet dhe aplikacionet:

- Aplikacionin për Azhurnimet Vjetore për Tarifat e KOSTT/ngarkesat e energjisë elektrike që do të zbatohen nga data 1 prill 2021 deri më 31 mars 2022.
- Komente ndaj Raportit Konsultativ- për përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2021, përgatitja e Aplikacionit Final për dërgim në ZRrE.
- Aplikacioni për Tarifat e OST/OT për vitin 2021.
- Aplikacioni për Shyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar për vitin 2021.
- Të dhëna sipas kërkesave nga ZRrE lidhur me shqyrtimin e jashtëzakonshëm.
- Monitorimi i projekteve kapitale 2018 – 2020.
- Njoftim rreth projektit Reaktori shant-variabil 100 MVAr 400 kV në NS Ferizaj 2.
- Sqarime lidhur me kostot e realizuara përfundim e BRE-ve për vitin 2020.

Sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin primar dhe sekondar janë dërguar Kërkesa për aprovim (të cilat janë në proces të aprovimit) dhe raportim në ZRrE:

- Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit dhe Procedurat për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit;
- Raportet Tremujore të Pajtueshmërisë me kushtet e Licencave për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Raportet mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit, Operatorit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut;
- Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara dhe Raportin e Auditorit të pavarur;
- Pasqyrat Vjetore të Kontabilitetit Rregullativ;
- Raportet Mujore për blerjen e energjisë elektrike përfundim e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe Raportin mujor përfundim e energjisë elektrike balancuese në ankandet ditore të organizuara nga KOSTT;
- Raportet Tremujore lidhur me energjinë e nominuar të BRE-ve, dërguar në Agjencionin e Statistikave të Kosovës.
- Raportet e Derogimeve përfundim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit.
- Kërkesë përfundim e kapacitetit ndërkufitar përfundim e shkëmbimin e rezervës automatike të restaurimit të frekuencës aFRR.
- Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2022 - 2031;
- Plani Zhvillimor i Transmetimit 2022 – 2031;
- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2022;
- Kërkesa përfundim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit
- Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2022 - 2031;
- Emërimi i Kryesuesit të KQKO-së
- Kërkesa përfundim të Derogim Modeli i Tregut dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike;
- Raport mbi Mangësitë e Sistemeve Matëse dhe Rekomandim përfundim të Sistemet Matëse;
- Informata lidhur me procesin e fillimit të marrjes së shërbimeve nga RSC (Regional Security Coordination Center).
- Formati përfundim i informacione teknike të kyçjes Marrëveshjet e Kyçjes;

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 24 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

- Raport mbi implementimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit;
- Njoftim për performancën e Bllokut Rregullues AK si dhe dy raporte të RG CE nga Seancat e Rregullta Plenare lidhur me këtë çështje;
- Njoftim për fillimin e implementimit të mekanizmit FSkar (Financial settlement of kΔf, ACE and ramping period);
- Raport për implementimin e marrëveshjeve të shërbimit për aFRR dhe mFRR;
- Njoftim për aplikimin e garacionit financiar për palët tregtarë;
- Njoftimin lidhur me arsyetim Teknik për blerjen e shërbimeve ndihmëse (rregullimi sekondar aFRR (+/- 25 MW) dhe terciar-mRR për ngritje (100 MW).
- Raport për nominimet e KEDS dhe KESCO.
- Marrëveshjet për Aderim në Rregullat e Tregut dhe Marrëveshjet për Palët Përgjegjëse për Balanc.

KOSTT ka dërguar në ZRRE dhe institucione tjera ( ATK, Polici të Kosovës, Komuna) Njoftime lidhur me rritjen e konsumit të energjisë elektrike në veri të Kosovës:

- Njoftim lidhur me furnizimin me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës (një në Prill 2021 dhe një në Shtator 2021);
- Kërkesë për zgjidhjen e problemit të mbulimit të kostos së obligimit përfurnizim me energji elektrike të pjesës veriore të Kosovës;
- Informim në lidhje me shqetësimin përrritjen e konsumit të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës;
- Kërkesë për anulimin e udhëzimit të ZRRE të datës 30 nëntor 2017 përfundit e licencuarit e sektorit të energjisë elektrike si dhe përmbledhjen e analizës financiare lidhur me kërkesën e parashtruar.

Si dhe në përgjithësi është dërguar shkresa përsituatën e rënduar me furnizim me energji elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës te Aksionari, Qeveria e Republikës së Kosovës, ZRRE dhe institucionet tjera në sektorin e energjisë elektrike:

- Siguria e sistemit dhe furnizimit me energji elektrike në Republikën e Kosovës.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2021, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit përvitit 2021.

### **3.2. Ngjarjet kryesore të vitit**

Në dhjetor të vitit 2021 për shkak të krizës energjetike dhe rritjes enorme të çmimeve të energjisë elektrike në treg kanë ndodhur devijime të mëdha të sistemit ndaj sistemit interkonektiv. Devijimet janë shkaktuar kryesisht për shkak të mungesës së mjaftueshme të gjenerimit në Kosovë p1% shkak të prishjeve në njësit gjeneruese në KEK, rritjes së konsumit mbi 9%, importit të pamjaftueshëm nga KESCO dhe KEDS si dhe një pjesë nga devijimet për shkak të konsumit në veriun e Kosovës. Përkundër këtyre vështirësive të mëdha KOSTT ka arritur ta mbaj sistemin stabil dhe garantoj sigurinë e furnizimit në Kosovë. Për shkak të pamundësisë të realizimit të importit nga KESCO dhe KEDS gjatë muajit dhjetor dhe rrezikimit të sigurisë



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 25 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

së operimit të sistemit Evropian KOSTT ka kërkuar nga palët në tregun e energjisë që të redukojnë konsumin për të balancuar sistemin dhe për të garantuar sigurinë e sistemit interkonektiv

### **Janar 2021**

-**Pas fillimit të operimit të KOSTT si Zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokur AK, institucionet kyçe të sektorit të energjisë vizituan KOSTT** - Koordinimi dhe bashkëpunimi i qëndrueshëm që mbizotëron në mes të institacioneve, si hallka të domosdoshme në zingjirin e sigurisë së furnizimit dhe funksionimit të sektorit të energjisë elektrike, edhe një herë u dëshmuant të jenë elemente thelbësore në përparimin e mëtutjeshëm të sektorit. Me këtë rast në janar 2021 KOSTT ndau mirënjojje për ZRR, KEK, KEDS dhe KESCO, në shenjë falënderimi për mbështetjen e vazdueshme në këto procese të rëndësisë primare për të ardhmen e sektorit të energjisë në Kosovë dhe KOSTT-in në veçanti.

-**Kontributi në mirëqenien e komunitetit, përkushtim i vazdueshëm i KOSTT sh.a** - Përkundër të gjitha sfidave si pasojë e pandemisë COVID 19, KOSTT arriti ta përmbyll vitin paraprak me sukses të theksuara, duke mos lënë anash asnijëherë përkushtimin për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë. Në kuadër të përksuhimit të KOSTT në këtë drejtim KOSTT realizoi mbështetje për: komunitetet e ndjeshme përmes Shoqatës Down Syndrome Kosova, Action for Mothers and Children /Aksioni për Nëna dhe Fëmijë #AMC dhe Shoqatën për ngritje të vetëdijes në zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit- #RENESANSA

-**Përfaqësues të Kontigjentit të Britanisë së Madhe të KFOR vizituan KOSTT** - Ekipi i njësitet britanez të KFOR gjatë muajit Janar 2021 kanë vizituar KOSTT-in ku u informuan në lidhje me operimin e përgjithshëm të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës me theks të veçantë situatën pas fillimit të operimit të pavarur të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Shqipëri-Kosovë.

-**Vlerësohet i suksesshëm operimi i Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)** - Në takimin e përbashkët i cili u mbajt me datë 29 janar 2021 në Tiranë në mes të delegacioneve të nivelit të lartë të KOSTT dhe OST Shqipëri u vlerësua lartë bashkëpunimi ndër-institucional dhe puna profesionale e ekipeve homologe që rezultuan me operimin e suksesshëm të Bllokut rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë (Blloku AK). Me këtë rast gjithashtu u ndanë mirënjojje për Administratorin e OST z.Skerdi Drenova dhe ekipin profesional të OST për mbështetjen e pakursyer të KOSTT në implementimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe fillimin e operimit të pavarur të Sistemit të Transmetimit të Kosovës si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK.

### **Shkurt 2021**

-**Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell** - Më 23 Shkurt 2021 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Solar Energy Gruop Europe sh.p.k. z.Egbert Schnuse, nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell (SGJED), me kapacitet gjenerues prej 150MWp (136MWac). Stacioni Gjenerues Energetik me Diell do të kyçet në rrjetin transmetues 110kV përmes linjës së re 110 kV



me gjatësi rrëth 6.5 km, e cila do të lidhet në NS 110/35kV Gjakova 1 dhe pritet që të fillojë me gjenerimin e megavateve të parë në vitin 2022.

**-Nënshkruhet marrëveshja për mbështetje të programit të KAEF (Fondi për Edukim Kosovar Amerikan)**

- Më 25 Shkurt 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe përfaqësuesi i KAEF z. Gjeni Shporta, nënshkruan marrëveshjen për mbështetje të programit të KAEF i cili i mundëson studentëve të diplomuar në universitetet e Kosovës shkollimin e nivelit Master në universitetet më prestigjoze në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**-Nënshkruhet edhe një Marrëveshje për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell** - Me 25 shkurt 2021 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Dukagjini Solar sh.p.k z.Cristopher James dhe z.Fadil Hoxha, nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell (SGjED), prej 2x96MW përmes linjës së re e cila do të lidhet në NS 400/110 kV Peja 3 dhe pritet që të fillojë me gjenerimin e megavateve të parë në vitin 2023.

**Mars 2021**

**-Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, vlerësohet kontributi dhe përkushtimi i çmuar i grave drejt arritjes së objektivave dhe avansimit të kompanisë** - KOSTT është e përkushtuar në arritjen dhe promovimin e barazisë gjinore brenda kompanisë, duke rritur përfshirjen e pjesëmarrjes profesionale të gruas në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse në funksion të krijimit të një fuqie punëtore më të balancuar në aspektin gjinor.

**-KOSTT promovon barazinë gjinore në vendin e punës** - Në kuadër të Programit ndërkombëtar për lidership, i zhvilluar në partneritet me Agjencinë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID), me 16 mars 2021 tre përfaqësues të KOSTT u diplomuan në Shkollën e Biznesit – McDonough, Universiteti Georgetown, në Programin e Lidershipit Ekzekutiv për Barazi Gjinore. Programi në fjalë i USAID, aplikon kurrikulen më të mirë në këtë kategori, që fuqizon ndërmarrjet nga mbarë bota në integrimin efektiv të iniciativave të barazisë gjinore brenda strukturave të korporatave të tyre. Nga ky program gati dy-vjeçar pjesë e së cilis ishte edhe KOSTT, u diplomuan tridhjetë menaxherë që punojnë në ndërmarrjet e ujësjellsit dhe energjisë nga vende të ndryshme të botës. Programi i leadershipit është pjesë e programit të USAID “Engendering Utilities”.

**-KOSTT promovon gjithpërfshirjen sociale** - Promovimi i gjithpërfshirjes sociale dhe i mundësive të barabarta si pjesë përbërëse të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm janë pjesë e përgjegjësisë korporative ku mobilizimi i komunitetit biznesor luan rol të rëndësishëm. Në këtë drejtim, KOSTT në kuadër të përkushitmit për integrimin e komunitetit me Sindromën Down dhe përgatitjen e të rinjve të këtij komuniteti të ndjeshëm për një jetë të pavarur, ka mundësuar punë praktike për dy të rinj të këtij komuniteti.

**-Menaxhmenti i KOSTT realizoi takim me përfaqësuesit e Tetra Tech** – Me 23 mars 2021 menaxhmenti i KOSTT realizoi takim konsultativ me përfaqësuesit e kompanisë Tetra Tech, implementuese e projektit mbështetës të USAID për sektorin e energjisë “Aktiviteti i Qëndrueshmërisë së Energjisë në Kosovë”. Projekti për një periudhë pesë vjeçare, në mes tjerash, do të ofrojë përkrahje për KOSTT në avansimin e

tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri përfshirë integrimin e mëtutjeshëm në tregun rajonal si dhe integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në Sistemin e Transmetimit përfshirë çështjen e balancimit të sistemit.

**-Përfaqësues të KFOR-it britanez vizituan KOSTT** - Në vazhdimësi të bashkëpunimit ndër-institucional, me 24 mars 2021 përfaqësuesit e kontigjentit të Britanisë së Madhe të KFOR vizituan KOSTT-in ku u informuan nga afér në lidhje me gjendjen aktuale si dhe funksionimin e gjithmbarshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me fokus në operimin e sistemit të transmetimit si hallkë kyçe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend.

**-KOSTT nënshkruan kontratë për ndërtim të nënstacionit të ri në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Komunën e Ferizajt** - Me 31 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani nënshkroi kontratën me përfaqësuesen e kompanisë ABB Power Grids Zagreb, znj. Nina Dusper Sushiç për implementimin e projektit për ndërtim të Nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaj 3. Ky investim kapital i KOSTT në vlerë prej mbi € 4.7 milion përvèç ndërtimit të nënstacionit të ri në Komunën e Ferizajt parashev edhe instalimin e transformatorit energjetik me fuqi prej 40 MVA (mega volt amper) në këtë nënstacion. Implementimi i projektit do të ketë ndikim të theksuar në rritjen e sigurisë dhe të kualitetit të furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit për rajonin e Komunës së Ferizajt duke mundësuar kushte për zhvillim të mëtutjeshëm ekonomik të komunës me rrethinë. Nga momenti i fillimit të punimeve, implementimi i projektit parashihet që të përfundojë në afat prej 24 muajsh

#### **Prill 2021**

**-Menaxhementi i KOSTT priti në takim drejtorin e çështjeve politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës** - Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë priti në takim drejtorin e çështjeve politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës z.Sylë Ukshinii cili u njoftu për procesin e gjatë disavjeçar nëpër të cilin ka kaluar #KOSTT drejt pavarësimit energjetik të Kosovës nga Blloku SMM dhe fillimit të operimit të pavarur në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

**-Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z. Qemajl Minxhozi priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT** - Në takim u bisedua rreth bashkëpunimit të gjertanishëm Kosovë-Shqipëri në sektorin e energjisë si dhe u shpreh rëndësia e pavarësimit energjetik të Republikës së Kosovës/KOSTT dhe fillimit të operimit të pavarur si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK. Duke vlerësuar si të shkëlqyer bashkëpunimin e deritanishëm në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri, palët shprehën gatishmërinë dhe vullnetit për bashkëveprim dhe projekte të përbashkëta në fushën e energjisë.

**-Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ministren e Ekonomisë znj.Artane Rizvanolli** – Në takimin e realizuar me 19 prill 2021, Ministrja Rizvanolli u njoftu me funksionimin dhe operimin e Sistemit të Transmetimit si hallkë kyçe në zingjirin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike si dhe me rrugëtimin e KOSTT drejt pavarësimit energjetik të Kosovës nga Blloku SMM. Ministrja Rizvanolli u njoftu gjithashtu me angazhimet që po bëhen për menaxhimin, operimin dhe balancimin e suksesshëm dhe stabil të Sistemit të Transmetimit të Kosovës në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E. Ministrja e Ekonomisë përgëzoi KOSTT-in për punën profesionale dhe vlerësoi lartë arritjet e KOSTT në të gjitha drejtimet.

## Maj 2021

- **Ambasadori i RF Gjermane në Kosovë Sh.T.Z. Jörn Rohde priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT –** Në takimin e mbajtur me 29 prill 2021 ambasadori Rohde u njoftua rreth zhvillimeve aktuale si dhe përgatitjeve në lidhje me investimet zhvillimore në pesë vitet e ardhshme të cilat do të janë në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të mëtutjeshëm të rrjetit të transmetimit të Republikës së Kosovës si hallkë kyçë në sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Ambasadori Rohde, u shpreh “Gjermania si partner strategjik ka mbështetur dhe shoqëruar KOSTT-in që nga themelimi i tij në vitin 2006 dhe jam i gjuar që edhe më tutje Gjermania do të këshilloj dhe shoqëroj KOSTT-in përmes bankës së mirënjer KfW.” Në shenjë falenderimi ndaj RF të Gjermanisë KShE i KOSTT z.Mustafë Hasani ndau Mirënjerje për Ambasadën Gjermane.

- **Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Qemal Minxhozi** - Në takimin e mbajtur me 11 maj 2021 u diskutua rreth bashkëpunimit të fryshtës në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në sektorin e energjisë si dhe operimin e suksesshëm të Bllokut AK. Duke marrë në konsiderim komplementaritetin e dy sistemeve energjetike, diversifikimin e burimeve të energjisë si dhe mbështetjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ishte dakordim I përbashkët që avansimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit është në interes të të dy vendeve.

- **KOSTT përfitues i grantit të USAID për avancimin e barazisë gjinore** - Në kuadër programit të USAID/Workforce Advancement for Gender Equality (WAGE), KOSTT është përzgjedhur përfitues i grantit për implementimin e projektit “Barazia gjinore për energji më të mirë” që do të zbatohet nga KOSTT nga muaji Prill 2021 deri Dhjetor 2021.

## Qershor 2021

- **KOSTT vlerëson partneritetin e vazdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës** - Në kuadër të vlerësimit të bashkëpunimit dhe përkrahjes së përhershme, Kryeshefi i KOSTT z.Mustafë Hasani dorëzoi mirënjerje për Ambasadën e SHBA në Kosovë si dhe për USAID në takimin I cili u organizua me datë 8 qershor 2021 me Joseph Farbeann, zyrtar ekonomik politik në Ambasadën e SHBA në Kosovë dhe z.Arben Nagavci specialist i menaxhimit të programit për energji në Agjencionin Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë.

- **Mbahet mbledhja e përgjithshme vjetore me përfaqësuesin e aksionarit** - Bordi i Drejtoreve të KOSTT udhëhequr nga Kryesuesi z.Jeton Mehmeti si dhe menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, me 11 qershor 2021 zhvilluan mbledhjen e përgjithshme vjetore me përfaqësuesin e aksionarit/Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Driton Tali, ku u prezantua dhe shqyrta Raporti Vjetor për vitin 2020, Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2020 si dhe performansa e menaxhmentit gjatë vitit. Pas shqyrimit dhe diskutimeve, z.Driton Tali, përfaqësues i Kuvendit të Kosovës-aksionarit të KOSTT, duke përfaqësuar të gjitha aksionet e lëshuara dhe evidentuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe votat përkatëse, pa vërejtje miratoi Raportin vjetor për vitin 2020 si dhe Raportin e Auditorit të pavarur në pasqyrat fiananciare për të njejtin vit.

- **KOSTT organizoi Forumin e parë në Kosovë me temë: “Roli i gruas në sektorin e energjisë – përvoja e KOSTT”** - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 15 vjetorit të themelimit të KOSTT, me datë 25 Qershor 2021 u mbajt Forumi virtual I nivelit të lartë me temë “Roli i gruas në sektorin e energjisë – përvoja e



KOSTT". Pjesë e panelit të diskutimit në këtë ngjarje ishin: znj. Artane Rizvanolli (Ministre e Ekonomisë), znj. Mimoza Kusari-Lila (Deputete në Parlamentin e Kosovës), znj. Sarah Olmstead (Drejtore për Kosovë, MCC), znj. Aurora Polo (Drejtore e Kabinetit, OST Shqipëri), znj. Jasmine Boehm (Këshilltare e menaxhimit të ndryshimeve, Tetra Tech via zoom platform), Znj. Xhyldane Kiçmari (Anëtare e Bordit, KOSTT), z. Mustafë Hasani (Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT), z. Kadri Kadriu (zv. Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT), znj. Bukurije Dauti (Menaxhere e Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit, KOSTT), Forumi u moderua nga znj. Zana Bajrami-Rama (Menaxhere për Komunikim dhe Relacione me Publikun, KOSTT).

**-Lansohet video projekti “Inspirohu në energji”** - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 15 vjetorit të themelimit të KOSTT, me datë 25 Qershor u lansa video projekti “Inspirohu në energji” që promovon rolin dhe përvojën inspiruese të disa nga gratë e suksesshme punonjëse të KOSTT. Ky video projekt u lansa në kuadër të Forumit të parë të organizuar në Kosovë ku u diskutua rrith rolit të gruas në sektorin e energjisë.

### **Korrik 2021**

**-Shënohet 15 vjetori i themelimit të KOSTT dhe gjashtë muaj nga pavarësimi i sistemit elektroenergetik të Republikës së Kosovës** - me datë 1 korrik 2021 KOSTT shënoi 15 vjetorin e themelimit, me një ceremoni zyrtare e cila u organizua në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës në Prishtinë. Në kuadër të kësaj ceremonie, gjithashtu u shnuan gjashtë muaj nga pavarësimi i Sistemit Elektroenergetik të Kosovës dhe fillimi i operimit si zonë e pavarur në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E, si një e arritur historike për sektorin e energjisë të Republikës së Kosovës. Duke marrë në konsideratë rëndësinë shtetërore e kombëtare të arritjeve të lartcekura, prezent në këtë ceremoni ishin SH.T.Z Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës, SH.T.Z Tomas Szunyog, Përfaqësues Special i BE në Kosovësi dhe personalitetë të tjera të larta shtetërore, të ambasadave të shteteve partnere në Kosovë, përfaqësues nga RGCE/ENTSO-E si dhe akterë të tjerë vendor dhe ndërkombëtar nga sektori i energjisë.

**-KOSTT filloj përgatitjet për investim kapital në ndërtimin e Nënstacionit të ri 110 kV në Ferizaj** - Në vazhdimësi të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, KOSTT ka filluar përgatitjet për realizimin e investimit kapital për ndërtimin e nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 (Kastriot). Në këtë drejtim, me date 9 korrik 2021 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani ka nënshkruar kontratë me Kryetarin e Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu, për shfrytëzim afatgjatë të promës komunale për ndërtimin e nënstacionit të ri si dhe trasenë e linjës përcjellëse 110 kV. Projekti për ndërtimin e Nënstacionit 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 sipas teknologjisë më të fundit GIS, është projekt i KOSTT i planifikuar për realizim bazuar në Planin Zhvillimor të Transmetimit 2018-2027.

**-KOSTT ri-çertifikohet me tri standarde ndërkombëtare** - Në vazhdimësi të përkushtimit për ngritjen e cilësisë dhe ekselencës së biznesit në përputhje me standarde ndërkombëtare, në 15 vjetorin e themelimit KOSTT u ri-çertifikua me: ISO 9001:2015 - Standardi i Menaxhimit të Cilësisë; ISO 45001:2018 - Standardi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe ISO 14001:2015 - Standardi i Mbrojtjes së Mjedisit. Këto certifikata të njohura dhe vlerësuara globalisht, të cilat vijnë pas një procesi rigoroz të verifikimeve dhe auditimit nga kompania ndërkombëtare certifikuese RoyalCert, e bëjnë KOSTT kompaninë e vetme publike në Kosovë të ri-certifikuar për të katërtën herë me tri ISO standarde ndërkombëtare të cilësisë. Përndryshe KOSTT ka filluar me certifikim për herë të parë me ISO standard ndërkombëtar që në vitin 2010.



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 30 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

**-Energjizohet linja e tensionit të lartë 110 kV që lidhë NS 110/35kV Vushtrria 1 me Parkun Energetik me Erë Selaci – Linja në fjalë me gjatësi prej 19.7 kilometrave u energjizua me datë 27 korrik 2021.**

### Gusht 2021

**-Prezantohet Raporti i Vlerësimit të Ndkimit në Mjedis për projektin e KOSTT për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 me infrastrukturë përcjellëse** - Nën organizimin e KOSTT dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më 19 gusht 2021 në ambientet e Kuvendit Komunal të Ferizajt si dhe përmes platformës online Zoom është mbajtur Debat Publik për çështjet ambientale të projektit në fjalë. Në Debatin Publik të gjitha palëve të interesuara u është ofruar mundësia që të parashtrojnë pyetje për çështje me interes në lidhje me projektin. Në bazë të analizës së prezantuar u konstatua që implementimi i këtij projekti nuk ka efekte të dëmshme domethënëse për mjedisin. Implementimi i projektit do të ketë ndikim pozitiv sa i përket krijimit të kushteve përfurnizim cilësor me energji elektrike për qytetarët e Komunës së Ferizajt, nga aspekti I transmetimit si dhe do të ndikoj në hapjen e një perspektive të re përf zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në këtë komunë.

### Shtator 2021

**-Menaxhmenti i KOSTT priti në takim delegacionin nga Ambasada e SHBA në Kosovë dhe USAID – Në takimin e organizuar 14 shtator 2021 me zyrtarët e lartë të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të USAID Misioni në Kosovë, zyrtarët e institucioneve amerikane u njofuan nga afër në lidhje me funksionimin aktual dhe operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike si dhe angazhimet e KOSTT në funksion të sigurisë së furnizimit me energji elektrike përf të gjithë qytetarët e vendit.**

**-Vëhet nën tension linja e re e tensionit të lartë 110 kV që lidhë NS 220/110 kV Kosova A me NS 110/35/10 kV Lipjani –** Me date 16 shtator 2021 është vënë nën tension linja e re 100 kV NS Kosova A - NS Lipjani, projekt ky i KOSTT i bashkëfinancuar me Bankën Evropiane përf Rindërtim dhe Zhvillim-BERZH

### Tetor 2021

**-Nënshkruhet Marrëveshja mbi bashkinin e tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë -** Zyra e Rregullatorit të Energjisë Kosovë dhe Enti Rregulator i Energjisë së Shqipërisë bashkërisht me operatorët e sistemit të transmetimit të të dyja vendeve KOSTT dhe OST më 21 Tetor 2021 në Tiranë nënshkruan marrëveshjen mbi bashkinin e tregjeve të energjisë elektrike. Përmes marrëveshjes palët nënshkruese e njohin Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX si bursë e vetme të energjisë elektrike përf tregtim një ditë para (day ahead) dhe gjatë ditës (intra-day) përf zonat tregtare të të dyja vendeve. Kjo marrëveshje njëherit është parakusht i marrëveshjeve pasuese që mundësojnë operacionalizimin e bursës së përbashkët të energjisë elektrike ALPEX. Nënshkrimi i marrëveshjes u realizua në kuadër të takimit të grupit punues ligjor përf definimin e aktiviteteve dhe marrëveshjeve që duhet të zbatohen në mënyrë që bursa e përbashkët e energjisë ALPEX të bëhet funksionale gjatë vitit 2022.

### Nëntor 2021

**-Delegacioni nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe KfW vizituan KOSTT -** Bashkëpunimi në mes të RF të Gjermanisë dhe Kosovës në sektorin e energjisë me fokus në projektet përf zhvillimin dhe modernizimin e sistemit të transmetimit si faktorë të rëndësishëm në sigurinë e furnizimit dhe integrimit në tregun rajonal dhe evropian të energjisë, ishin temat kyçë në takimin e zhvilluar në mes të zyrtarëve të



lartë të RF të Gjermanisë dhe Kosovës. Delegacioni i Qeverisë Gjermane në përbërje të Volker Oel, drejtor në Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik të RF të Gjermanisë (BMZ), Michaela Brinkhaus, zyrtare përgjegjëse për Kosovën nga BMZ, René Eschemann, drejtor i zyrës së KfW për Kosovë dhe Maqedoninë Veriore si dhe zyrtarë të tjerë të lartë nga KfW dhe GIZ u priten në ambientet e KOSTT nga u.d.Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu, zv.Ministri për Ekonomi z.Mentor Arifaj, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë nga Ministria e Ekonomisë dhe KOSTT. Në kuadër të takimit gjithashtu u theksua rëndësia e bashkëpunimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit, në mbështetje të sigurisë së furnizimit me energji elektrike si faktor kyç për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e mirëqenie shoqërore në vend.

### Dhjetor 2021

**-KOSTT 1 vit zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë** - Më 14 Dhjetor 2021 u shenua 1 vit nga pavarësimi i Sistemit Elektroenergetik të Kosovës dhe fillimi i operimit të KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E.Një kapitull i ri në funksionimin e Sistemit Elektroenergetik të Kosovës si dhe në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në vend dhe e arritur historike për sektorin e energjisë të Republikës së Kosovës.

**-Kriza energetike** - Si reflektim i rritjes së theksuar të konsumit të energjisë elektrike në vend, pamjaftueshmërisë së gjenerimit të brendshëm për të mbuluar konsumin dhe krizës globale energetike që ka rezultuar me rritjen enorme të çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare, Sistemi Elektro-Energetik i Kosovës është përballur me vëshirësi të theksuara. Si rrjedhojë e mosbalancës së theksuar në mes të konsumit të energjisë elektrike në vend dhe energjisë së siguruar nga operatorët përgjegjës në treg, janë shkaktuar imbalance të mëdha ndaj sistemit interkonektiv. Qendra Koordinuese për Evropën Kontinentale në kuadër të ENTSO-E (SwissGrid) si dhe Grupi Regional i Evropës Kontinentale (RGCE) trup i ENTSO-E kanë kërkuar në mënyrë strikte ndërpren e menjëherëshme të devijimeve ndaj rrjetit interkonektiv evropian, derisa monitoruesi i Bllokut AK në vazhdimësi ka tërhequr vërejtjen zonës rregulluese të Kosovës për situatën. Për të ruajtur integritetin e sistemit dhe kontribuar në balancimin e Sistemit Elektroenergetik të Kosovës dhe ate Evropian, Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST-të) janë të obliguara që të ndërmarrin të gjitha veprimet për të balancuar konsumin, gjenerimin dhe importin brenda zonës së tyre rregulluese, andaj në dhjetor 2021 KOSTT ka bërë thirrje publike që të shfrytëzohet energjia elektrike në mënyrë sa më racionale duke kursyer aty ku është e mundur si dhe ka kërkuar mobilizim të të gjitha palëve të licencuara në tregun e energjisë për të ndërmarrë masa në përputhje me përgjegjësitë e tyre për tejkalimin e sitates. Kjo thirrje është bërë me qëllim të shmangjes së zbatimit të masave të parapara me Kodin e Rrjetit/Kodi Operativ për zvogëlimin e konsumit si masë e fundit e veprimit.

**-KOSTT u certifikua me Standardin ndërkombëtar ISO 27001:2013 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit (ISMS).** KOSTT si kompani lidere në sektorin publik për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë, përmes këtij certifikimi globalisht të njojur, dëshmoi angazhim serioz në zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në sigurinë e informacionit, mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit konform standardit ISO/IEC 27001:2013. Me këtë KOSTT bëhet kompania e parë publike dhe kompania e parë në sektorin e energjisë në Kosovë e certifikuar me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2013, duke e përmbyllur kështu vitin 2021 me një sukses që dëshmon vazhdimësi të ekselencës së biznesit.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 32 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 4. Operimi i Sistemit

### 4.1. Marrëveshja e Kyçjes (Connection Agreement) KOSTT – ENTSO-E

Pas shumë përpjekjeve, për të realizuar të drejtën e KOSTT që të operoj si Zonë Kontrolli e pavarur, fillimisht më 15.10.2015 KOSTT ka nëshkruar Marrëveshjen e Kyçjes (Connection Agreement) me ENTSO-E, mirëpo për shkak të problemeve politike nuk ka arritur që të aktivizohet në atë kohë.

Më pastaj, pas insistimeve tona të vazhdueshme, kjo marrëveshje, pra Connection Agreement KOSTT-ENTSO-E hyri në zbatim më 14 Dhjetor 2020, dhe KOSTT ka filluar të operoj si Zonë Kontrolli Frekuencë-Fuqi (LFC Load-Frequency Control), brenda Bllokut Kontrollues (Control Block) AK (Albania – Kosovo).

KOSTT merrë obligime dhe njëkohësisht zotohet se të gjitha detyrat që dalin konform Rregulloreve të EU (EU Regulation), Kodeve të Rrjetit (Network Codes), Udhëzimeve (Guidelines) etj. ndaj ENTSO-E do të përbushen.

ENTSO-E aktivizon grupin për detyrat dhe obligimet që ka KOSTT, të quajtur PG KOSTT (Project Group KOSTT), përmes dokumentit të quajtur Catalogue of Measures, të ndara sipas prioriteteve.

Dhe, Operimi i Sistemit, në mënyrë permanente gjatë tërë vitit 2021, ka punuar maksimalisht, fillimisht duke bërë testimet e nevojshme, për të përbushur këto detyra me prioritet siç janë: dimensionimi i rezervave, aktivizimi i rezervave, krijimi dhe dërgimi i fajllave Day Ahead Contingency Files (DACF), kalkulimet NTC etj.

### 4.2. Funksionalizimi i Bllokut të Kontrollit (Control Block) AK – procedurat

Për të funksionalizur Bllokun e Kontrollit AK, janë krijuar grupe punuese të përbashkëta KOSTT-OST. Janë krijuar këto procedura, të cilat aplikohen në praktikë:

- Metodologja për Rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK.
- Procedura për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK.

### 4.3. Krijimi dhe dërgimi i fajllave DACF (Day Ahead Control Files) në Swissgrid

Nga Operimi i Sistemit, çdo ditë pune, për 24 orë, krijohen fajllat DACF të cilët përfshijnë planifikimin e konsumit, gjenerimit, topologjinë e rrjetit, dhe importet/eksportet për Zonën e Kontrollit KOSTT.

Këta fajlla, së pari dërgohen në OST, dhe më pas OST i dërgon në Swissgrid.

#### **4.4. Kalkulimi i Net Transfere Capacities (NTC)**

KOSTT ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me OST (TSO e Shqipërisë), CGES (TSO e Malit të Zi) dhe me MEPSO (TSO e Maqedonisë) për vlerësimin e kapaciteteve transmetuese në kufirin përkatës. E njëjtë gjë ende nuk është bërë me EMS (TSO e Serbisë), sepse pala tjetër akoma nuk është e gatshme.

Këto vlerësime bëhen në baza vjetore, mujore, dhe kur paraqitet nevoja edhe në baza javore dhe ditore. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerësimet dhe kalkulimet e NTC-ve me TSO-të fqinje, vjetore dhe mujore:

<b>Vlerësimi i NTC (Net Transfer Capacities) - 2021</b>							
		Vjetore:					
		KOSTT - OST	OST - KOSTT	KOSTT - MEPSO	MEPSO - KOSTT	KOSTT - CGES	CGES - KOSTT
		200	200	100	100	100	100
<b>Mujore:</b>							
		KOSTT - OST	OST - KOSTT	KOSTT - MEPSO	MEPSO - KOSTT	KOSTT - CGES	CGES - KOSTT
Janar 2021	18.01.-31.01.2021	250	250	400	330	300	300
Shkurt 2021	01.02.-28.02.2022	250	250	360	330	300	300
Mars 2021	01.03.-31.03.2021	250	250	250	150	300	300
Prill 2021	01.04.-30.04.2021	250	250	200	100	300	300
Maj 2021	01.05.-31.05.2021	250	250	100	170	300	300
Qershor 2021	01.06.-30.06.2021	400	400	400	400	300	300
Korrik 2021	01.07.-31.07.2021	400	400	450	450	300	300
Gusht 2021	01.08.-31.08.2021	400	400	370	370	300	300
Shtator 2021	01.09.-31.09.2021	400	400	230	200	300	300
Tetor 2021	01.10.-31.10.2021	400	400	250	350	300	300
Nentor 2021	01.11.-30.11.2021	400	400	220	250	300	300
Dhjetor 2021	01.12.-31.12.2021	400	400	250	250	300	300
Janar 2022	01.01.-31.01.2022	400	400	300	250	300	300
Shkurt 2022	01.02.-28.02.2022	400	400	350	250	300	300


*Tabela 3                  Vlerësimi i NTC*

Vërejtje: Vlerat nga tabela e mësipërme kanë pasur ndryshime në disa data apo orë caktuara në rastet kur ka pasur shkyçje të planifikuara të linjave të interkoneksionit.

Pas kalkulimit të NTC-ve për secilin kufi, për të gjitha time-frames, këto vlera dërgohen në SEE CAO (Coordinated Auction Office in South East Europe (SEE CAO) me seli në Podgoricë/Mali i Zi, të cilat mund të shihen në linkun e mëposhtëm:

<https://www.seecao.com/>

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 34 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	



Croatia	HOPS	Hrvatski operator prijenosnog sustava d.o.o.
Bosnia and Herzegovina	NOSBH	Nezavisni operator sistema u Bosni i Hercegovini
Montenegro	CGES	Crnogorski elektroprivredni sistem AD
Albania	OST	Operatori i Sistemit te Transmetimit
Kosovo	KOSTT	Operator sistemi, transmisioni dhe tregu Sh.A.
Greece	IPTO	Independent Power Transmission Operator S.A.
Turkey	TEIAS	TÜRKİYE ELEKTRİK İLETİM A.Ş.
North Macedonia	MEPSO	Operator na elektroprenosniot sistem na Republika Sjeverna Makedonija

Figura 4      <https://www.seecao.com/>

SEE CAO kryen alokimin explicit të kapaciteteve transmetuese ndërkufitarë ndërmjet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit aksionar dhe Përdoruesve të Shërbimeve (Service Users).

#### 4.5. Publikimi i të dhënave në Platformën e Transparencën në ENTSO-E

Duke u bazuar në detyrat që dalin nga EU Regulation 543/2013 (COMMISSION REGULATION 543/2013 on submission and publication of data in electricity markets) ndaj ENTSO-E, për publikimin e të dhënave në Platformën e Transparencës, KOSTT ka për detyrë të publikoj të gjitha të dhënat relevante energjetike.

Operimi i Sistemit, në bashkëpunim edhe me Operatorin e Tregut, ka implementuar me sukses projektin për publikimin e të dhënave tona në Platformën e Transparencës të ENTSO-E, me ofruesin e këtij shërbimi Novita, të cilat mund të shihen online nga ENTSO-E Platforma e Transparencës, në linkun e mëposhtëm:

<https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show>

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 35 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	




Figura 5 <https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show>

Këto të dhëna (ku disa nga to publikohen në ditën D – pas realizimit, e disa të dhëna të planifikuara-javore, mujore, vjetore) vijnë nga të gjitha fushat: Ngarkesa (load), Gjenerimi (generation), Balancimi (balancing), Shkyçjet (outages), Transmisioni (transmission) etj.

#### 4.6. Instalimi i pajisjeve MDC për monitorim të rrjedhave të energjisë - çdo 1 sek.

Gjatë vitit 2021 është arritur që të instalohen pajisjet e reja MDC (angl. Meter Data Collection) në rreth 70% të nënstacioneve të KOSTT me qëllim që të bëhet monitorimi i rrjedhave momentale të energjisë, të cilat janë të ndërlidhura drejtëpërdrejt me njehsorët elektrik. Pajisjet MDC janë instaluar në të gjitha pikat matëse në Gjenerim dhe Interkoneksion (përveç në pjesën veriore) ndërsa në NS distributive 110/xkV është mbuluar pjesa më e madhe e tyre (rreth 70%).

Gjithashtu, këto pajisje kanë mundësi që të ndërlidhen edhe me sistemet lokale të SCADA nëpër nënstacione për shkak se nga daljet (output) të dhënat janë me protokoll IEC 870-5-104, i cili është kompatibil me protokolin e njëjtë që e shfrytëzon sistemi SCADA. Përmes tyre, të dhënat nga njehsorët do të përcillen në sistemin SCADA në intervalin kohor çdo 1 sekond, duke bërë që matjet në SCADA të jenë sa më të sakta.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 36 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 4.7. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

### 4.7.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2021

Detyra e operimit të sistemit gjatë vitit 2021 ka qenë krijimi i kushteve për implementimin të planeve paraprakisht të aprovuara të palëve tregtare sipas Bilancit. Në vijim janë paraqitur disa të dhëna bazuar në analizën e bilancit të planifikuar dhe të realizuar për vitin 2021.

Vlerat janë sistemuar në formën tabelare për periudhën (Janar-Dhjetor) 2021, ku vlerat e planifikura dhe të realizuara janë paraqitur në sasi të MWh, si dhe është treguar përqindja e realizimit në raport me planin për periudhën relevante.

Nga tabela vërehet se prodhimi vendor ishte më i lartë se plani për 22,15%. Ka pasur zvogëlim të importit për 16,49% dhe rritje të eksportit krahasuar me atë të planifikuar. Konsumi neto i Kosovës ka qenë më i lartë se plani për 7,11%.

Humbjet në transmetim kanë qenë më të larta për 11,80% krahasuar me ato të planifikura, kjo për arsyе të rritjes për 7,11% të konsumit të Kosovës si dhe hyrjeve nga interkoneksioni në rrjetin e transmetimit.

Gjatë kësaj periudhe, KOSTT mundësoi realizimin e të gjitha planeve të miratuar të palëve tregtare si prodhuesve TC KEK, HC Ujmani, HC Lombardhi, Air Energy Kitka, Air energy Selaci (në operim nga Shtatori 2021), furnizuesit publik KESCO, konsumatorëve të mëdhenj të lidhur në rrjetin transmetimit Ferronikeli, Sharr Cem dhe Trepça. Pra nuk ka pasur ankesa në realizimin e kërkësave të palëve tregtare për shkak të rrjetit transmetimit.

Të dhënat e planifikura janë paraqitur bazuar në dokumentin e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike 2021 të miratuar nga ZRRE, ndërsa të dhënat e realizuara janë marrë nga pikat matëse dhe të transferuara në kufirin elektrik të rrjetin e transmetimit të Kosovës.



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 37 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2021		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	2 012 273	2 165 010	107.59
(2) TC Kosova B	2 741 200	3 736 330	136.30
(3) HC Lumbardhi	96 368	61 656	63.98
(4) HC Ujmani	83 000	109 453	131.87
(5) Parku i erës-KITKA	93 958	80 493	85.67
(6) Parku i erës Selaci	48 000	45 822	95.46
*(6)= 1+2+3+4+5+6 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 074 800	6 198 764	122.15
(7) Devijimi		- 138 401	
(8) Shërbimet ndihmëse	0	- 77 559	
(9) Eksporti	211 224	834 638	395.14
(10) Importi	1 570 331	1 311 461	83.51
(10*) = 6-7-8-9+10 Energjia në disponim	6 433 907	6 891 547	107.11
(11) Distribucioni	5 220 867	5 568 689	106.66
(12) Ferronikeli	429 240	315 669	73.54
(13) Sharri	69 300	56 563	81.62
(14) Trepça	21 400	10 698	49.99
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	114 301	142 508	124.68
(16) Humbjet për konsumin e Veriut	326 918	371 711	113.70
(17) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	138 346	298 775	215.96
(18) = 11+12+13+14+15+16+17 Kërkesa neto	6 320 372	6 764 612	107.03
(19) Humbjet në transmission	113 535	126 936	111.80
(20) =18+19 Kërkesa gjithsej	6 433 907	6 891 547	107.11

Tabela 4

Bilanci i Energjisë Elektrike të planifikuarë dhe të realizuarë për vitin 2021

Rritja e prodhimit të energjisë elektrike në TC Kosova B në raport me prodhimin e planifikuar ka ndodh si rezultat i operimit të dy njësive pavarësisht se ka qenë e planifikuar të ndalet njëra njësi për remont për një periudhë të gjatë. Kjo gjithashtu ka reflektuar që importi i planifikuar të jetë më i vogël se i parashikuar.

Disa prej të dhënave kryesore nga tabela 4 **Error! Reference source not found.** janë ilustruar edhe në diagramin në vijim, pra janë paraqitur kërkesa (konsumi), prodhimi neto i Kosovës, importi dhe humbjet teknike në rrjetin transmetues të Kosovës:




Figura 6 Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2021

Në vazhdim, është paraqitur figurativisht bilanci i shpërndarjes së gjithë energjisë elektrike që hynë në rrjetin transmetues të Kosovës drejt destinacioneve për periudhën Janar-Dhjetor 2021.




Figura 7 Bilanci i realizuar i energjise elektrike ne GWh Janar-Dhjetor 2021

#### **4.8. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit**

Nr	Indikatori		Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	2021/2020(%)	Caku	Komenti
T1	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhën e raportimit)		79	62	78.43	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1	Koha mesatare e mos furnizimit të konsumatorëve për të cilën shkaktar ka qenë KOSTT, ka qenë më e ultë për 21,57% gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.
T2	Numri i ankesave për tension		2	1.00		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T3	Numri i ankesave për matje		0	0			
T4	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	41	24	58.95	30MWh/h tërheqje jashtë programit të deklaruar	Vlera mesatare e devijimeve ka qenë në import (tërheqje nga sistemi) 41,05% më e ultë se në periudhën e njëjtë 2020, ndërsa eksport (shtyrje në sistem) 76.20% më e lartë se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.
		Eksport	5	9	176.20	30MWh/h shtyrje jashtë programit të deklaruar	



## RAPORT VJETOR 2021

**DT-FI-010**

ver. 1.0

fazë 41 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

T5	Humjet në transmision (GWh)		113	127	112.06		Humjet në transmision kanë qenë më të larta për 12,06% krahasuar me vitin 2020. Kanë qenë më të larta ngase hyrjet në rrjetin e transmetimit (prodhimi dhe hyrjet nga interkoneksioni) kanë qenë për 7% më të larta si dhe për shkak të rritjes së konsumit për rreth 11% krahasuar me vitin paraprak.
----	-----------------------------	--	-----	-----	--------	--	--

Tabela 5 Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

## 5. Operimi i Transmisionit

### 5.1. Rrjeti transmetues aktual i Kosovës

Rrjeti transmetues i Kosovës është zhvilluar gjatë 60 viteve të fundit në disa faza të ndërtimit, zgjerimit, përforcimit dhe konsolidimit. Rrjeti aktual transmetues përbëhet prej **1410.5 km** gjatësi të linjave, duke përfshirë:

- 279.5 km në nivelin e tensionit 400 kV;
- 238.5 km në nivelin e tensionit 220 kV dhe
- 892.5 km në nivelin e tensionit 110 kV.

Kapaciteti transformues i instaluar i rrjetit horizontal të transmetimit përbëhet prej 16 auto-transformatorësh me kapacitet total 3750 MVA, duke përfshirë:

- 1200 MVA në nivelet e tensionit 400/220 kV ( 3 ATR)
- 1200 MVA në nivelet e tensionit 400/110 kV (4 ATR)
- 1350 MVA në nivelet e tensionit 220/110 kV ( 9 ATR)



Kapaciteti transformues i instaluar i rrjetit vertikal të transmetimit përbëhet prej 65 transformatorësh me kapacitet total 2320 MVA, duke përfshirë:

- 160 MVA transformator 220/35/10 kV dhe 220/10 kV (4 TR)
- 340.5 MVA transformator tre-pështjellorë 110/35/10 kV (8 TR-3psh)
- 618 MVA transformator në nivelet e tensionit 110/35 kV ( 19 TR)
- 1201.5 MVA transformator në nivelet e tensionit 110/10 kV ( 34 TR)

Në kuadër të transformatorëve të tensionit të lartë të kyçur në rrjetin e transmetimit që nuk menaxhohen nga KOSTT janë:

- 320 MVA 220/35 kV ( 2 TR- Feronikeli)
- 126 MVA, 110/35/6.3 kV dhe 110/6.3 kV ( 4 TR-Trepça, aktualisht 3 jashtë punës)
- 40 MVA, 110/6.3 kV ( 2 TR- Sharr-Cem)
- 20 MVA, 110/6.3 kV ( Ujmani- IbërLepenci)

Rrjeti transmetues i Kosovës operon me 37 nënstacione të niveleve të ndryshme të tensionit dhe atë:

- 1 nënstacion 400/220 kV,
- 2 nënstacione 400/110 kV
- 3 nënstacione 220/110 kV
- 2 nënstacione 220/35/10 kV dhe 220/10 kV
- 8 nënstacione 110/35/10 kV
- 6 nënstacione 110/35 kV dhe
- 15 nënstacione 110/10(20) kV

Në rrjetin e transmetimit janë të kyçura edhe tri nënstacione që menaxhohen nga industria si: Ferronikeli (220/35 kV), Trepça (110/35/6.3 kV) dhe Sharr-Cemi (110/6.3 kV).

Sa i përket kapacitetit interkonektiv rrjeti transmetues i Kosovës karakterizohet si rrjet mjaft mirë i ndërlidhur me rrjetin regional me linjat:

- **400 kV**
  - NS Kosova B - NS Komani (Shqipëri)
  - NS Kosova B - NS Nish (Serbi)
  - NS Peja 3 - NS Ribarevina (Mali i Zi)
  - NS Ferizaj 2 - NS Shkupi 5 (Maqedonia Veriore)
- **220 kV**
  - NS Prizreni 2 B - NS Fierza (Shqipëri)
  - NS Podujeva - NS Krushevci (Serbi)

Në operim janë edhe dy linja 110 kV ndërkufitare me Serbinë ajo NS Vallaq - NS Novi Pazar dhe NS Berivojce - NS Bujanovc.

## 5.2. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit

Nr	Indikatori	Niveli i tensionit	Vlera max (2016-2020)	2021	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV		Janar Dhjetor	2021/ *Koeficient max. në vitet (2016-2020)		
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.11	1.24	11.70	>1	<ul style="list-style-type: none"> <li>-LP437/2 (L405) NS Peja 3-SSH Ribarevina, ka pasur nevojë për intervenim si pasojë e lidhjes së shkurt me tokën.</li> <li>- Ka ndodh lidhja e shkurtër në LP 407.</li> <li>- Ne LP205/2 në shtyllën nr.26 është realizuar ndërrimi i izolatorëve në zonën kufitare.</li> <li>- Në linjën LP126/2(L113),LP126/5 (L115) dhe LP164/2(L124), lidhje e shkurtër me tokën.</li> </ul>
		220	0.77	0.86	1.11		
		110	0.92	1.28	1.39		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	4.27	7.76	1.82	>1	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në linjën 184/2(L130) lidhje e shkurtër me tokën</li> <li>Në linjën LP407(L401), në shtyllën 17B Ka ndodh lidhja e shkurtër me tokën</li> </ul>
		220	8.65	2.37	0.27		
		110	4.85	8.62	1.78		



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 44 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	1.60	0.00	0.00	<1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	2.1	0.00	0.00	<1	
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10(20)	15.68	10.00	0.64		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.00	0.00	>1	Intervenim në NS Klina, dëmtim të kabllove te TR1-shit. Intervenim ne TR2 në NS Ferizaj 1, ku deri te intervenimi ka ardhur si pasojë e rënies së trafos me ndikim në konsum (plotësimi me vaj).
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10(20)	9.73	11.00	1.13		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0.00	>1	Intervenim ne TR2 në NS Ferizaj 1, ku deri te intervenimi ka ardhur si pasojë e rënies së trafos me ndikim në konsum (plotësimi me vaj).
		220/110	0.00	0.00	0.00		
		110/35/10	11.03	12.50	1.13		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0.00	≤1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110		0.00	0.00		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0.00	0.00	<1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.4	0.00	0.00		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0.00	<1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.5	0.00	0.00		



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 45 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

<b>T1 0</b>	Numri i prishjeve në mbrojtje reale/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.64	0.00	0.00		
<b>T1 1</b>	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje reale/kontroll (orë)	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	1.14	0.00	0.00		
<b>T1 2</b>	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes reale/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0.00	< 1	
		220	0.00	0.00	0.00		
		110	0.00	0.00	0.00		

Tabela 6

Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit

\*Koeficientet maximale ndër vitet 2016-2020 janë marrë parasysh për kalkulime më të sakta të IKP-ve

Ndër të arriturat e Departamentit të Transmisionit gjatë vitit 2021 të cilat vlen të përmenden janë:

### A. Rezultatet e vitit 2021

Realizimi i përgjithshëm i planit vjetor të mirëmbajtjes për vitin 2021 është realizuar:

- a) 99% nga SMRNS-QP;
- b) 98% nga SMRLP;
- c) 87% nga SMMR;
- d) 97% nga QS.

### B. Aktivitetet tjera të Operatorit të Transmisionit

- Kontrollimi vizual i stabilimenteve dhe operimi sipas kërkesave të QDN;
- Realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve;
- Analizimi i prishjeve dhe përgatitja e raporteve;
- Janë kryer specifikimet teknike për pjesë rezervë për mirëmbajtje;
- Pjesëmarrje në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave;
- Pjesëmarrje në komisionet për auditim të brendshëm të SIM;
- Pjesëmarrje në komisionet për vendosjen e shenjave unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes.

### C. Problemet të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2021 në Linja dhe Nënstacione janë:

- Aktivitetet e parapara në NS Vallaçi për të gjitha sektorët nuk janë realizuara për arsyte të pa mundësisë për qasjen në pjesën Veriore të Kosovës;

- Shqyrtimi i mbrojtjes reale për shkak të pamundësisë për shkyçje, arsyeta kriterit N-1 nuk është realizuar në TR1 në NS Prishtina 7, aktivitet i paraparë për tremujorin e katërt të vitit 2021.

## 6. Operimi i tregut

### 6.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral. Në këtë Treg mungon konkurenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë 8 furnizues të licencuar (KESCO Sh.A., GSA ENERGJI Sh.P.K., HEP-KS Sh.P.K., Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K., Jaha Company SH.P.K., Sharr Cem SH.P.K., KEK SH.A. dhe ENERCO LLC) për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, aktualisht vetëm KESCO bën furnizimin e të gjithë konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të pa rregulluar.

Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm tre konsumator të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmisionit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse SharriCemi, dhe Trepça, PEE Selaci dhe PEE Kitka në nivelin 110kV) ndërsa të gjithë konsumatorët tjera furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Gradualisht sipas afateve te përcaktuara nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë (ZRR) edhe konsumatorët e kyçur ne nivelin 35kV dhe 10kV duhet të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të janë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal

Të dhënat themelore energjetike janë dhënë në vijim:




Figura 8

Të dhënat themelore energjetike




Figura 9 Tregu i rregulluar dhe pa rregulluar

## 6.2. Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues

Më 14 dhjetor 2020 KOSTT ka filluar operimin e pavarur si Zonë Rregulluese dhe si pjesë e Bllokut Rregullues Shqipëri – Kosovë (AK).

Nga kjo ditë ka filluar edhe alokimi i kapaciteteve interkonektive të KOSTT me TSO – fqinje (përjashtuar Zonën Rregulluese të EMS-it) nga Zyra për Alokim të Koordinuar (CAO) në Podgoricë. Alokimi i kapaciteteve interkonektive në emër të KOSTT pritet të sjell zhvillime të reja në tregun (dhe në madhësinë e tregut) e energjisë elektrike në Kosovë.

Kapacitetet e linjave Transmetuese në kufirin ndërmjet zonave të pavarura rregulluese KOSTT (Republika e Kosovës) – EMS (Republika e Serbisë) nuk alokohet për shfrytëzim komersial për shkak se pala serbe nuk ka nënshkruar marreveshjet interkonektive me KOSTT për alokimin e kapaciteteve transmetuese. Mungesa e këtij kapaciteti në treg shkakton kosto shtesë të shkëmbimeve ndërkufitar të energjisë elektrike në Kosovë dhe në region për shkak të paraqitjes së kongestioneve.

Duke pasur parasysh rrëthanat e reja të krijuara me hapjen e tregut, KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRR duke bërë fillimisht krijimin e llogarive të energjisë për palët tregtare të regjistruara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

Gjithashtu nga aspekti i llogaritjeve energetike dhe të pagesave nga Operatori i Tregut (OT) menaxhohen këto llogari:

- Llogaria e prodhuesve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)
- Llogaria prodhuese e KelKos Energy (HC Lumbardhi I);
- Llogaria prodhuese e KEK-ut;

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 48 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

- Llogaria prodhuese e HC Ujmanit;
- Llogaria e KEDS për humbje në shpërndarje;
- Llogaria e KOSTT për humbje në Rrjetin e Transmetimit;
- Llogaria e KOSTT për humbjet në Sistem (konsumi i veriut)
- Llogaria e furnizimit për KESCO për konsumatorët e rregulluar (Shërbimi Universal);
- Llogaria e furnizimit për KESCO për konsumatorët e parregulluar
- Llogaria për Fondin e Energjisë së Ripërtëritshme dhe
- Llogaria Balancuese.

Në muajin Prill 2021 dhe Maj 2021 në treg është paraqitur furnizuesi i ri aktiv FET (Future energy Trading). Të gjitha Llogaritë përmbajnë shënimet për çdo periodë të barazimit përfundimtar (për çdo orë) për energjinë e nominuar (kontraktuar), energjinë e matur dhe obligimet financiare të llogaritura për çdo periodë të barazimit përfundimtar (proces i barazimit energetik dhe finanziar). Në bazë të dhënave nga këto llogari krijohen raporte të cilat përdoren si bazë për faturimin e ndërsjellë mes palëve në treg si dhe për faturimin e pagesës së jobalanceve.

Sipas mekanizmit balancues të gjitha palët të cilat dështojnë të përbushin obligimet e tyre sipas nominimeve (obligimeve kontraktuale) paguajnë ose paguhen nga llogaria balancuese për energjinë e jobalancit me çmimin e jobalancit.

Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë është dhënë në vazhdim, ku shihet që Korporata Energetike e Kosovës (KEK) dhe KESCO janë palë dominante në treg:




Figura 10 Pjesëmarrja në tregun e energjisë elektrike në Kosovë

KOSTT si Operator i Sistemit Transmetues, bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike (Neni 19 dhe 23), është përgjegjës për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në përputhje me procedurat transparente jo-diskriminuese dhe të bazuar në treg. KOSTT nga 01.04.2017 energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit është duke e blerë në tregun e energjisë elektrike me çmim të de-rregulluar.

Në vazhdim, është dhënë diagrami i pjesëmarrjes së blerjes së humbjeve nga KEK dhe nga Ankandi ditor:




Figura 11 Pjesëmarrja e blerjes së humbjeve nga KEK dhe Ankandi

KOSTT gjatë vitit 2021 ka balancuar sistemin duke përdorur rezervën automatike aFRR, rezervën manuale mFRR, energjinë balancuese të realizuara gjatë ditës (Intraday), programin e kompensimit dhe mekanizmin e kompensimit Evropian Fskar.

Nga 1 Qershor 2021 ka filluar së implementohet mekanizmi i pagesave të Shkëmbimeve të Qëllimshme dhe të Paqëllimshme të energjisë elektrike të Zonës Rregulluese të Kosovës nga/për Zona Sinkrone përmes mekanizmit të ashtuquajtut Fskar të ENTSO-E.




Figura 12 Pjesëmarrja e blerjeve të energjisë nga ana e KOSTT për vitin 2021



### 6.3. Fondi BRE (Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë elektrike)

Ligi për Energinë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085 ndër tjera obligon Operatorin e Tregut për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të. Në këtë kuadër ZRrE ka miratuar Rregullën për Skemën Mbështetëse, e cila përcakton se Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar kanë të drejtë të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek OT në KOSTT, përmes Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) të lidhur me KOSTT-in. Energjia elektrike e prodhuar nga gjeneratorët BRE që kanë të lidhur MBE me KOSTT paguhet me tarifë nxitëse (67.47 €/MWh për HC, 85 €/MWh për Burime të Erës, 136.40 €/MWh për Burime Fotovoltaikë dhe 71.30 €/MWh për Biomasë solide), ndërsa kohëzgjatja e MBE-ve është 10 vite për Hidrocentrale dhe Biomasë solide, dhe 12 vite për Burime Fotovoltaikë dhe të Erës. Edhe gjatë vitit 2021 KOSTT ka vazhduar procesin e nënshkrimit të MBE-ve me Gjeneratorët BRE, numri i të cilave aktualisht është 31 me kapacitet të instaluar gjithsej 234 MW. Prej tyre në Operim Komercial janë gjithsej 28 Gjeneratorë BRE, me kapacitet të instaluar gjithsej 191 MW.

Për të mbuluar kostot e prodhimit nga Gjeneratorët BRE, bazuar në dispozitat e Rregullës për Skemën Mbështetëse (Neni 13), është themeluar Fondi për Energinë e Ripërtëritshme që menaxhohet nga OT. Për operimin e këtij foni, OT i raporton ZRrE-së në baza tremujore. Nëpërmjet Fondit për Energinë e Ripërtëritshme, Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar paguhën për prodhimin e tyre, ndërsa furnizuesit paguajnë për energjinë e ripërtëritshme me çmim referent të miratuar nga ZRrE në proporcion me pjesëmarrjen e konsumit të tyre individual në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë.

Në tabelën në vijim janë paraqitur energjia e prodhuar nga gjeneratorët BRE të cilët kanë nënshkruar MBE me KOSTT (OT) për blerje të energjisë:

**RAPORT VJETOR 2021**

ver. 1.0

**DT-FI-010**

faqe 52 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Burimet e Renovueshme të energjisë (BRE)	Energjia e matur e BRE-ve [MWh]
PE Kitka	80493
HC Lepenci 3	25124
HC Deçani	24615
PEE Selaci 1	22750
HC Belaja	16689
HC Brodi 2	13676
HC Orqusha	12143
HC Albaniku 3	11761
HC Brodi 3	11370
PEE Selaci 2	6814
HC Albaniku 2	6259
HC Restelica 1&2	5993
PSF Frigo Food	4179
PSF Birra Peja	4166
PSF Solar Green Energy	3375
HC Brezovica	2918
HC Vica	2620
Hc Binqa	1729
Hc Bresana	1150
HC Restelica 3	895
HC Brodi 1	732
HC Dragashi	696
PSF Onix	637
PSF Eling	620
HC Albaniku 4	357
PSF Led Light	126
HC Shterpca	620

Tabela 7

Prodhimi nga BRE pjesëmarrës në Skemën Mbështetëse

**RAPORT VJETOR 2021**

ver. 1.0

**DT-FI-010**

faqe 53 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

**7. Pasqyra e performancës financiare dhe Rezultatet****7.1. Pasqyra e Pozicionit Financiar****31.12.2021****ne (000) Euro****2020****2021**

Palujtshmëritë, impiantet dhe pajimet	159,547	145,194
Pasuritë e pa prekshme	821	607
Inestimet ne shoqeri/financiare	343	908
<b>A) Pasuritë jo qarkulluese</b>	<b>160,711</b>	<b>146,709</b>
Stoqet, pjesët rezervë dhe veglat	4,381	4,448
Arkëtueshmëritë	11,106	26,769
Kerkesat tjera	1,039	357
Avanset	127	1,685
Paradhënie për tatim në fitim	-	426
Kërkesat nga jobalancat	1,326	48,612
Depozitat me afat, garacion dhe interesit akrual	47,236	17,064
Paraja në arkë dhe bilanci bankar	17,951	35,450
Paraja nga granti Qeveritar	10,000	-
<b>B) Pasuritë qarkulluese (kapitali punues)</b>	<b>93,166</b>	<b>134,810</b>
<b>GJITHESEJT AKTIVA A + B</b>	<b>253,877</b>	<b>281,520</b>
<b>C) Kapitali Aksionar</b>	<b>126,479</b>	<b>99,831</b>
Kapitali aksionar	25	25
Kapitali i trashëguar	53,367	53,367
Fitimi i mbajtur	57,042	73,087
Fitimi për periudhë	16,045	(26,648)
<b>D) Detyrimet Afategjate</b>	<b>108,601</b>	<b>88,196</b>
Të hyrat e shtyera	56,302	47,256
Të hyrat e shtyera nga granti Qeveritar	7,673	2,327
Obligimet për Kredi	44,626	38,613
<b>E) Detyrimet Afatshkurtëra</b>	<b>18,797</b>	<b>93,493</b>
Pagueshmëritë dhe obligimet tjera	17,438	41,667
Obligimet nga jobalancat	1,359	51,826
<b>Gjithesejt Detyrimet D + E</b>	<b>127,398</b>	<b>181,689</b>
<b>GJITHESEJT PASIVA C + D + E</b>	<b>253,877</b>	<b>281,520</b>

Tabela 8

Pasqyra e Pozicionit Financiar

## 7.2. Pasqyra e të ardhurave

31.12.2021

**Euro (000)**

	<b>Realizimi Janar- Dhjetor 2020</b>	<b>Buxheti Janar- Dhjetor 2021</b>	<b>Realizimi Janar- Dhjetor 2021</b>	<b>% realizimit ndaj buxhetit</b>
Të hyrat nga rrjeti 220 /400 kV	419	342	342	100%
Të hyrat nga rrjeti 110 kV	19,660	16,282	16,282	100%
Të hyrat nga sistemi i operimit	12,341	12,812	13,481	105%
Të hyrat nga operatori i tregut	352	320	328	102%
Të hyrat për humbje nga përshtatjet e KEK	3,052	3,329	2,228	67%
Te hyrat nga tarifa dhe fondi për Burimet e Ripërtritshme	25,046	27,518	29,662	108%
<b>1. Gjithësejt të hyrat nga tarifat</b>	<b>60,870</b>	<b>60,604</b>	<b>62,323</b>	103%
Të hyrat tjera operative	303	500	481	96%
Të hyrat nga interesë	544	375	924	246%
Te hyrat nga alokimi i kapaciteteve interkonektive	108	3,700	4,575	124%
Të hyrat nga granti Qeveritar per Veriun	2,327	7,673	7,673	100%
Të hyrat nga jobalanca	242	-	66	-
Të hyrat nga jobalanca nga importi	1,619	-	-	-
Të hyrat nga tranziti i energjisë	298	350	155	44%
Të hyrat e shtyera	6,976	6,900	6,718	97%
Të hyrat nga dividenta (CAO)		-	23	-
<b>2. Gjithësejt të hyrat tjera</b>	<b>12,418</b>	<b>19,498</b>	<b>20,614</b>	106%
<b>GHITHËSEJT TË HYRAT (1+2)</b>	<b>73,288</b>	<b>80,103</b>	<b>82,938</b>	104%
<b>Shpenzimet operative</b>	<b>39,121</b>	<b>93,820</b>	<b>93,260</b>	99%
Mirëmbajtja	753	1,172	827	71%
Pagat e statifit	5,353	5,792	5,052	87%
Pagat për Bordin e Drejtoreve	31	107	80	75%
Shërbimet ndihmëse	229	8,381	7,107	85%
Shpenzimet tjera operative	1,941	1,770	1,553	88%
Humbjet në transmision	4,773	6,538	10,857	166%
Humbjet në sistem në veri	-	33,211	34,133	103%
Humbjet në sistem në veri nga granti Qeveritar	2,327	7,673	7,673	100%
Humbjet në veri me përbartim	1,642	0	0	-
Shpenzimet e interest per kredi	1,607	1,507	1,370	91%
Shpenzimet e tranzitit	81	150	428	285%
Shpenzimet nga tarifa dhe fondi për Burimet e Ripërtritshme	18,672	27,518	23,129	84%
Shpenzimet nga jobalanca	93	0	599	-
Shpenzimet nga jobalanca import	1,619	0	0	-
Shpenzimet e provizioneve për konteste gjyqësore			452	
<b>Fitimi para amortizimit</b>	<b>34,167</b>	<b>(13,717)</b>	<b>(10,322)</b>	75%
Zhvlerësimi/Amortizimi	16,257	16,500	15,777	96%
<b>Gjithësejt shpenzimet (operative+amortizimi)</b>	<b>55,378</b>	<b>110,320</b>	<b>109,037</b>	99%
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>17,910</b>	<b>(30,217)</b>	<b>(26,099)</b>	86%
Shpenzimet e tatimit në fitim	-1,865	0	-549	-
<b>Neto Fitimi / Humbja</b>	<b>16,045</b>	<b>(30,217)</b>	<b>(26,648)</b>	88%

**RAPORT VJETOR 2021****DT-FI-010**

ver. 1.0

faqe 55 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

**7.3. Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

	<b>Kapitali Aksionar</b>	<b>Rezervat e Transferit</b>	<b>Fitimet e mbajtura</b>	<b>Gjithësejt</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>25</b>	<b>53,367</b>	<b>57,043</b>	<b>110,435</b>
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	16,045	16,045
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	0	0	16,045	16,045
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>25</b>	<b>53,367</b>	<b>73,087</b>	<b>126,479</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2021</b>	<b>25</b>	<b>53,367</b>	<b>73,087</b>	<b>126,479</b>
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	(26,648)	(26,648)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	0	0	(26,648)	(26,648)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>25</b>	<b>53,367</b>	<b>46,439</b>	<b>99,831</b>

Tabela 10

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

**RAPORT VJETOR 2021**

ver. 1.0

**DT-FI-010**

faqe 56 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

**7.4. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë****Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Operative 2021**

Fitimi/Humbja para Tatimit	(26,099)
<i>Përshtatjet për:</i>	
Zhvleresimi dhe amortizimi	15,777
Të hyrat nga interesë	(924)
Shpenzimet e interesit	1,370
Provizonet dhe detyrimet tjera	471
Hedhja e pasurive fikse	3
Të hyrat e shtyra nga grantet	(14,392)
<b>Rrjedha operative e parasë para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>(23,794)</b>
Rritje/Zvogëlim në stoqe	(67)
Rritje/Zvogëlim në llogari të arkëtueshme dhe kerkesa tjera	(15,439)
Rritje/Zvogëlim në llogari të arkëtueshme nga jobalanca	(47,285)
Rritje/Zvogëlim në avanse	(1,558)
Rritje/Zvogëlim në llogari të pagueshme dhe obligime tjera	24,251
Rritje/Zvogëlim në llogari të pagueshme nga jobalanca	50,467
Tatimi mbi fitimin (i paguar)	(975)
Pagesa nga SOWI në llogarinë e mirëbesimit	143
<b>Paraja e gjeneruar nga Aktivitetet Operative</b>	<b>(14,256)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Investive</b>	
Interesi i arkëtuar	997
Pagesa për investimet në shoqëri	(566)
Blerja e aseteve të reja	(1,315)
Zvogëlimi i mjeteve nga depozita	30,000
Dividentë e pranuar	23
<b>Paraja e gjeneruar nga Aktivitetet Investive</b>	<b>29,139</b>
<b>Rrjedha e parasë nga Aktivitetet Financuese</b>	
Interesi i paguar	(1,370)
Huatë e paguara	(6,014)
<b>Paraja e gjeneruar nga Aktivitetet Financuese</b>	<b>(7,384)</b>
<b>Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>7,499</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 01.01.2021	27,951
<b>Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 31.12.2021</b>	<b>35,450</b>

Tabela 11

Paqyra e Rrjedhës së Parasë

## 7.5. Analiza e IKP-ve financiare

Treguesit	I-XII 2020	I-XII 2021	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginjinal = Fitimi neto /gjithsejtë të hyrat	<b>0.22</b>	<b>(0.32)</b>	<p>Qëllimi është që të jetë <b>mbi zero</b>.            Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.</p> <p>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.</p> <p>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.</p>
<b>T2. Treguesi i likuiditetit</b> = pasuria qarkulluese/detyrimet qarkulluese	<b>4.91</b>	<b>1.44</b>	<p>Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurtër. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurtër.</p> <p>Treguesi duhet të jetë <b>më i madh se 1</b>.</p>
<b>T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave=kërkesat *365 ditë/të hyrat</b>	<b>63.35</b>	<b>142.54</b>	<p>Ky tregues është i matshëm në baza vjetore</p> <p><b>Caku: ≤ 90 ditë</b></p>
<b>T4. Giring</b> = kreditë afatgjate jashtë vendit/kapitali*100	<b>34.81</b>	<b>38.68</b>	<p>Ky tregues tregon raportin mes borxhit total afatgjatë dhe kapitalit. Është një tregues për të matë levën financiare, duke demonstruar shkallën në të cilën aktivitetet e një kompanie janë financuar nga fondet e kompanisë kundrejt fondeve të kreditorit.</p> <p><b>Caku: &lt; 60%</b></p>

Tabela 12

Analiza e IKP-ve financiare

Shënim:

Rritja e obligimeve dhe kërkesave në krahasim me vitin paraprak është si pasojë e vështirësive në inkasim për shkak të situatës energjetike dhe mos pagesës nga KEDS/KESCO.

Pasqyra e të ardhurës ka rezultuar me humbje në vlerën 26 milion e 648 mijë € për shkak se KOSTT sh.a gjatë vitit 2021 me Rekomandimet e Kuvendit të Kosovës Nr. 08-R-01 i datës 06.05.2021 ka mbuluar shpenzimet e humbjeve ( furnizimit ) të pjesës veriore të Kosovës pa mbulim nga tarifa apo ndonjë mekanizëm tjeter në vlerën 34 milion e 133 mijë euro. Kjo ka ndikuar që Indikatori T1 të jetë jashtë cakut të vendosur me Planin e Biznesit për vitin 2021.

Nëse këto mjete do të mbuloheshin nga tarifa apo ndonjë mekanizëm tjeter, KOSTT sh.a edhe përkundër rritjes së çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në Transmision do të rezultonte me fitim para tatimit në vlerën prej 8 milion e 34 mijë euro.



## RAPORT VJETOR 2021

**DT-FI-010**

ver. 1.0

faqe 58 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Si pasojë e vonesave në ikasimin e të hyrave nga KESCO/KEDS , indikatori T3 është jashtë cakut të vendosur me Planin e Biznesit .

Për shkak të rritjes enorme të kostos së energjisë elektrike në treg duke filluar nga gjysma e vitit 2021 e cila ka ndikuar në koston shumë të lartë të importit, në fund të vitit 2021 ZRrE ka hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike për të mbuluar kostot shtesë të energjisë elektrike në sektorin e energjisë elektrike.

## 7.6. Progresi me planin e Biznesit

KOSTT sh. a, është ndërmarrje publike, që zë një vend të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë dhe e cila vepron si Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës. KOSTT drejtohet me ligjin korporativ të emërtuar si Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Në përputhje me Ligjin e Energjisë Elektrike dhe licencat e lëshuara, KOSTT është përgjegjës për:

- Transmetimin e energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në licencë, në mënyrë objektive, transparente dhe jo diskriminuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ruajtur sigurinë e sistemit elektroenergetik sipas këtij ligji;
- Operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmetimit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri afatgjatë të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit;
- Administrimin, operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese;
- Menaxhimin e procesit të Barazimit Përfundimtar të Palëve në treg;
- Operimin e Sistemit të Transmetimit në pajtueshmëri me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme, në mënyrë që të arrijë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin ekonomik të rrjetit të transmetimit;
- Planifikimin e operimit të sistemit elektroenergetik, në bashkëpunim me Operatorin e Tregut dhe operatorët e sistemeve të transmetimi të shteteve fqinje, si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të Rrjetit;
- Balancimin e sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut;
- Sigurimin e besueshmërisë dhe disponueshmërisë së sistemit të transmetimit, në mënyrë që të mundësojë furnizim të sigurt me energji elektrike, duke mbajtur mjaftueshmërinë e kapaciteteve të transmetimit;
- Mundësimin përdoruesve në qasje dhe shfrytëzim të rrjetit të transmetimit sipas parimeve transparente dhe jo diskriminuese;
- Ofrimin e informatave operatorëve të sistemeve fqinje, me të cilët është i ndërlidhur sistemi i transmetimit, me qëllim të arritjes së operimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të interkonektuara; etj.
- Përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës SCADA/EMS për realizimin e funksioneve të operimit të sistemit të transmetimit;
- Menaxhimin e fondit të BRE
- Menaxhimin e procesit të ndërrimit të furnizuesit.

Përveç përgjegjësive primare të cekura më lartë, KOSTT ka edhe përgjegjësitë sekondare, që janë:

- që të ofrojë shërbimet e shfrytëzimit të fibrave optik (komerçialisimi i fibrave optik) në infrastrukturën e telekomunikacionit në tërë vendin, si dhe vendet e rajonit në bashkëpunim me OST-të përmes rrjetit transmetues të KOSTT dhe linjave interkonektive. Në këtë drejtim,

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 60 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

përgjegjësitë e KOSTT-it përcaktohen nga Ligji për Telekomunikacion dhe Ligji për Komunikime Elektronike si dhe Autorizimi/Licenca e lëshuar nga ARKEP-i.

- Dhënia e shërbimeve të konsulencës në nivel lokal dhe ndërkombëtar;
- ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta (kyçja e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në rrjetin e transmetimit, si dhe ndërtimet e objekteve afër rrjetit të transmetimit).

## Misioni

Misioni i KOSTT-it është:

- Operimi i sigurt dhe i besueshëm i Sistemit të Transmetimit, duke garantuar sigurinë e furnizimit, si dhe operimin efikas të tregut të energjisë elektrike në bazën e transparencës dhe jo diskriminimit, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës.

## Vizioni

“Të jetë kompani kredibile, që garanton transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptimin social dhe mjedisor, e integruar në rrjetet dhe institucionet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike ”.

## Vlerat themelore

**Siguria dhe Besueshmëria:** transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike për të gjitha palët e kyçura në Sistemin e Transmetimit të Kosovës, në përmbrushje të objektivës për sigurinë e furnizimit cilësor dhe zhvillim të qëndrueshëm.

**Përgjegjësia:** Në përmbrushjen e obligimeve si kompani publike KOSTT përdor resurset në mënyrë sa më optimale dhe është e përkushtuar në mirëmbajtjen, zhvillimin dhe avancimin e vazdureshëm të Sistemit të Transmetimit, duke krijuar vlerë për aksionarin. KOSTT është e përkushtuar dhe e përgjegjshme ndaj palëve, punonjësve, komunitetit, mjedisit dhe shoqërisë në përgjithësi.

**Bashkëpunimi:** KOSTT-i vazhdimesht favorizon dhe kultivon bashkëpunimin dhe punën ekipore, që shpie në kryerjen e detyrave drejt arritjeve të përbashkëta, për të përmbrushur misionin e saj dhe zhvillimin afatgjatë të kompanisë.

**Transparenca:** KOSTT qeveriset mbi bazën e transparencës dhe llogaridhënieς. KOSTT ofron qasje jo-diskriminuese për të gjitha palët e kyçura në Rrjetin e transmetimit, zbaton me transparencë procedurat si dhe ofron informacione të hapura për të gjitha palët e tregut të energjisë elektrike, palët e interesit dhe opinionit në përgjithësi.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 61 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

**Dija:** Përmes përvetësimit të vazhdueshëm të njohive, dhe përvojës shumëvjeçare, KOSTT ndërtion profesionalizmin e tij, përmirëson performancën dhe mbetet e përkushtuar në gjetjen e zgjidhjeve më të mira për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

## Moto e KOSTT

### Energjia jonë, zëri i së ardhmes!

Me qëllim që të realizojë synimet e përcaktuara, KOSTT ka vendosur objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
2. Mirëmbajtja dhe operimi i sigurt dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit;
3. Krijimi i kushteve për një treg të liberalizuar dhe të integruar të energjisë elektrike
4. Krijimi i tregut të organizuar një ditë para dhe tregut balancues të energjisë elektrike;
5. Sigurimi i stabilitetit finansiar të kompanisë;
6. Operimi si LFC zonë në kuadër të AK LFC Bllokut
7. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjera ndërkombëtarë;
8. Avancimi i partneriteti me palët e interesit;
9. Të jetë punëdhënës atraktiv, duke siguruar barazinë gjinore dhe që investon në zhvillimin profesional të punonjësve, të talenteve dhe në avancimin e dijes;
10. Të jetë kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, në aspektin social dhe mjedisor;
11. Të krijojë një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune;
12. Menaxhimi i cilësisë dhe avancimi i ndërmarrjes sipas standardeve ISO;
13. Rritja e të hyrave nga shërbimet për shfrytëzim të infrastrukturës së sistemit të telekomit dhe nga shërbimet tjera sekondare;
14. Akomodimi i kyçjeve të reja në rrjetin e transmetimit;
15. Kontribuoj në mbarëvajtjen e punës për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI).



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 62 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Objektivat e lartcekura do të shërbejnë për analizimin e të arriturave të KOSTT gjatë vitit 2021, respektivisht, për implementimin e Plani të Biznesit për vitin referues.

Gjatë vitit 2021, janë realizuar 98% të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së linjave dhe 99% të mirëmbajtjes së Qarqeve primare, 100% Qarqet sekondare dhe 97% Mbrojtjet reale. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt transformatorëve dhe i fushave, termovizioni, shpërndarja e gazrave (DGA), shqyrtimet e mbrojtjeve reale, zëvendësimi i pjesëve dhe pajisjeve të domosdoshme në sistem, si dhe aktivitetet e planifikuara të mirëmbajtjes si pjesë e zhvillimit të projekteve dhe komisionimit të tyre.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive si: realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve, analizimi i prishjeve, Analiza e rënieve dhe Operimeve, specifikimet teknike, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për pranim teknik, pjesëmarrja në implementimin e projekteve të ndryshme në Kostt, Popullimi i shënimeve të aplikacionit QGIS për LP etj. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmisionit, kjo ka kërkuar një menaxhim dhe optimizim maksimum të ekipeve në teren.

KOSTT do të vazhdojë edhe më ngritjen profesionale të stafit të mirëmbajtjes për teknologjinë e re në nënstacione dhe situatën e re të krijuar në linja, pas investimeve në linja të dyfishta si dhe kompletimin më tutje të pajisjeve të nevojshme.

Duke konsideruar perspektivën për angazhim në projekte të reja (biznese tjera jo të rregulluara), mundësia më evidente për KOSTT-in tani është dhënia e shërbimeve nga lëmi i telekomunikacionit përkatësisht, paraqitja në treg e kapaciteteve tepricë të fijeve optike. Këto kapacitete telekomunikuese janë ndërtuar me qëllim të zhvillimit të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të operimit të sistemit të transmetimit, andaj detyrë kryesore është (dhe do të jetë në të ardhmen): Sigurimi i mbështetjes telekomunikuese për biznesin kryesor të KOSTT-it.

Gjatë vitit 2021 KOSTT ka vazhduar me nënshkrimin e marrëveshjeve me kompani vendore për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre). Që nga viti 2004, paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi prej 1210 km të vendosur nëpër largpërcues të tensionit të lartë.

Në përputhje me nenin 5.2 dhe 5.3 të Regullores për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike) dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, gjatë vitit 2021, KOSTT sh.a nënshkroi një marrëveshje të re (me Kujtesën) për ofrimin e shfrytëzimit me qira të rrjetës së fibrave optik (dark fibër/të pa-ndriçuar). Shërbimi i Fibrave të pa-ndriçuar u mundëson operatorëve të lidhin teknologjitet e tyre përkatëse të transmetimit optik me fibrat e pasfrytëzuara të rrjetit të KOSTT-it, për të ofruar shërbimet e veta të transmetimit në tërë territorin e Kosovës.

Duke hyrë në tregun e telekomunikacionit të Kosovës, KOSTT:

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 63 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

- Zgjerohet në aktivitete të reja telekomunikuese, përvèç aktivitetave ekzistuese.
- Është më i përgatitur për t'u përballuar me sfidat e tregut të Kosovës: tani dhe në të ardhmen.
- Realizon fitim shtesë.
- Arrin një shkallë më të lartë të efektivitetit të biznesit të KOSTT-it.
- Mund të bashkëpunoj me operatorët fqinj të infrastrukturës së telekomunikacionit (në bazë të marrëveshjeve rajonale).
- Mbanë një licencë të Operimit të Shërbimeve të Infrastrukturës së Telekomunikacionit.
- Kontribuon në zhvillimin e TIK-ut në Kosovë.

Deri më tani janë komercializuar 26 linçe optike me 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) fije optike, me gjatësi prej: 640.67 km.

Projekti Autostrada Digitale Ballkanike/"Balkans Digital Highway", i mbështetur nga Banka Botërore (BB), është duke vazhduar me zhvillimet dhe këshillime për të adresuar kërkesën për shfrytëzimin e kapaciteteve të tepërtë në rrjetet ekzistuese me fije optike si një iniciativë rajonale për bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës telekomunikuese.

Në mbështetje të plotë nga BB është marrë edhe iniciativa për aplikim në WBIF ("Western Balkans Investment Framework") për një grant për Asistencë Teknike për realizimin e studimit të fizibilitetit, dizajnimin e projektit dhe analizën cost-benefit për projektin "Balkans Digital Highway", i cili ka karakter lokal dhe rajonal sepse në të po marrin pjesë katër vende nga Ballkani Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi.

Sa i përket sistemit telekomunikues për të ngritur disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit janë bërë disa ndërhyrje në linçet dhe pajisjet telekomunikuese, si:

- Kthimi në funksion i linkut telekomunikues NS Skenderaji – NS Vallaqi,
- Është bërë riparimi dhe kthimi në funksion i OPGW-së në linjën NS Ferizaj – NS Therandë, pas dëmtimeve që janë shkaktuar nga kushtet atmosferike.
- Pas djegies së NS Trepça, është bërë kthimi në funksion i pajisjeve dhe linçeve telekomunikuese,
- Është bërë kthimi në funksion i pajisjeve telekomunikuese në NS Rahoveci
- Janë instaluar pajiset telekomunikuese në kuadër të projektit NS Selaci.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese ekzistuese në nënstacione. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispeçerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, në shfrytëzimin më të mirë të aplikacioneve të SCADA/EMS, si dhe në ngritjen e saktësisë së të dhënavës në SCADA/EMS, si:

- Korrigimi i parametrave të rrjetit me qëllim të akordimit të State Estimatorit me SCADA/EMS dhe mundësimit të analizave kontingjente,



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 64 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

- Freskimi i topologjisë të rrjetit të transmetimit të observuar në nivel rajonal,
- Adaptimi i modulit “Outage Schedule” për përcjelljen e shkyçjeve në formë elektronike;
- Testimi dhe implementimi i sistemit të AGC KOSTT – OST me QDN të OST;

Edhe gjatë vitit 2021, KOSTT ka vazhduar investimin në përmirësimin e performancës dhe kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit. Është realizuar kalimi nga versionet e vjetra të Sistemeve Operative në versionet e reja si në pjesën serverike ashtu edhe në atë të shfrytëzuesve. Janë instaluar po ashtu edhe softuerët e tjerë profesional si dhe paketi i Office 2019 (projekti “Licenca të Microsoftit dhe migrimi i sistemit të TIK”).

Në fokus të stabilitetit, sigurisë dhe funksionalitetit sa më optimal të punës, është ndërtuar dhe lëshuar në punë edhe qendra e re e serverëve ku në një hapësirë të përbashkët janë vendosur sistemet e teknologjisë operacionale, të informacionit dhe asaj telekomunikues të KOSTT duke përbushur standardet ndërkontrollare të cilësisë dhe sigurisë për pajisjet dhe funksionimin e tyre. Krahas kësaj janë bërë po ashtu përgatitjet për ndërtimin e qendrës së re emergjente (sipas planit operacional) gjatë vitit 2022, për të siguruar vazhdimësinë e biznesit të KOSTT në rast të avarive të ndryshme.

Siguria kibernetike edhe më tutje ka vazhduar të jetë prioritet dhe objektiv e vazhdueshme e sidomos në implementimin e procedurave dhe politikave të reja/rifreskuara gjatë përgatitjeve për certifikimin që tashmë është realizuar në KOSTT me standardin e sigurisë së informacionit ISO27001:2013 si dhe kontrollin dhe përmirësimin sistematik ku kontrolli dhe përmirësimi sistematik i tyre është vlerësuar gjatë auditmit.

Gjatë vitit 2021, ashtu si edhe vitet e mëparshme, si objektiv e saj, KOSTT ka punuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e saj si në rregullimin e hapësirave të punës ashtu edhe në krijimin e kushteve tjera më të mira për punë, duke vazhduar me renovimin e nënstacioneve duke u bazuar në eficencën e energjisë dhe mirëmbajtjen e rregullt të tyre. Gjatë vitit 2021 janë rinnovuar nënstacionet NS 110kV Gjakova 2, NS 110kV Prishtina 3, dhe NS 220kV Podujeva, duke zëvendësuar dyert dhe dritaret e vjetësuara metalike me ato termike, duke izoluar termikisht fasadat, si dhe punë të tjera që do të lehtësonin mirëmbajtjen e rregullt të Nënstacioneve si dhe është rinnovuar kulmi në NS Gjilani 1. Projekte të tjera të realizuara gjatë këtij viti janë edhe: Punimi i inventarit për zyra për DOT(Departamentin e operimit të tregut) dhe sallën e takimeve të KE, Projekti: Punët ndërtimore në fushën e Linjës 110kV në NS Trepça, Kanali i kabllove nga betoni armuar NS Prishtina 2, etj.

Gjithashtu janë realizuar projekte që kanë të bëjnë me infrastrukturën ndërtimore të Nënstacioneve të KOSTT si kyçja në infrastrukturë të qytetit e ujit/kanalizimit në SSH Drenas dhe NS Skënderaj.

Siguria fizike në KOSTT, e cila nënkuon mbrojtjen e të gjitha aseteve të Kompanisë KOSTT nga kërcënimet me vjedhje apo dëmtime, gjatë vitit 2021 edhe përkundër shumë rasteve të tentim vjedhjes dhe vjedhjeve, është arritur që asetat vitale të mbahen të pacenuara, dhe si rezultat i kësaj nuk është rrezikuar për asnjë moment funksionimi i punës nëpër objekte dhe nënstacione të KOSTT-it, të cilat do të mund të ndikonin në vazhdimësinë e punës. Në muajin nëntor ka filluar me realizim Kontrata e re kornizë trevjeçare për sigurim fizik.

Nga aspekti i sigurisë fizike është përfunduar punimi i rrethojave në NS Theranda dhe SSH Drenasi si dhe ndriçimi përreth tyre.



Projekti: Punimi i depos së mbyllur në Obiliq ku deponohen të gjitha pjesët rezervë të nevojshme për intervenimet e rregullta si dhe ato emergjente e të gjitha NS dhe linjave të cilat mirëmbahen nga KOSTT për arsyet mungesës Bordit të OSHP- së është bartur në vitin 2022.

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe përkujdesi për shëndetin e punëtorëve, i cili është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët edhe gjatë vitit 2021, meqenëse Ligji për sigurimet shëndetësor ende nuk është implementuar. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv si dhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrolllet sistematike mjekësore, të cilat për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia e shkaktuar nga korona virusi Covid-19, kanë devijuar nga plani për vitin 2021, por duke arritur që të realizohen kontrolllet sistematike mjekësore kryesisht për vendet e punës në kushte specifike të punës.

Me qëllim të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, KOSTT i kushton kujdes të veçantë, sigurisë së aseteve dhe menaxhimit mjedisor duke përbushur: furnizimin me pajisje mbrojtëse; informimin dhe përkrahjen gjatë implementimit të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja,nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; realizimin e matjeve të dëmtuesve fiziko-kimik, kushteve mikroklimatike dhe intensitetit të fushave elektromagnetike në vendin e punës; angazhimin mbi zhvillimin e projektit për siguri dhe mjedis dhe sipas planit zhvillimor; zhvillimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndeti në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit konform rregullativës ligjore dhe kërkësave nga certifikimi me standartet ISO 14001 dhe ISO45001; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.

KOSTT edhe gjatë vitit 2021, si edhe deri më tanë, ka ofruar mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për student. Për shkak të pandemisë nga Covid-19 dhe organizimit online të procesit mësimor në universitete, është ndikuar edhe procesi i praktikës profesionale.

Pjesërisht është arritur zbatimi i marrëveshjeve për praktikë profesionale mes KOSTT - "Kosovo CSR Network", KOSTT- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe KOSTT-Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë (UBT), KOSTT – MCC, KOSTT – Down Sindrom Kosova. Në këtë drejtim KOSTT ka shpreh gatishmërinë për të kontribuar në zhvillimin dhe përkrahjen e studentëve dhe profesionistëve të rinj në fushën e energjisë elektrike dhe në bashkëpunim me partnerët, do ta bëjë edhe në të ardhmen.

Me qëllim të përkrahjes financiare për studentët në sektorin e energjisë elektrike, KOSTT gjatë viti 2021 ka zhvilluar konkursin publik për ndarje të 10 bursave për studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike për vitin akademik 2021/2022. Të gjitha procedurat e konkursit dhe përzgjedhjes janë zhvilluar konform Politikës për ndarjen e bursave dhe pas përfundimit të procesit, 10 studentë-bursist kanë filluar të marrin bursat nga muaji tetor 2021.



Nga perspektiva e Planit të Biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRrE-së. Në bazë të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), KOSTT ka përgatitur dhe dorëzuar në ZRrE Aplikacionin për Përshtatjet e Rregullta Vjetore për vitin 2021 si dhe Aplikacionin për Tarifat e Vtit 2021.

Në vitin 2018 ZRrE ka kryer procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e dytë Rregullative (PRR2) 2018-2022 për KOSTT. Në pajtim me Rregullat e të Hyrave këto parashikime duhen azhurnuar për të marrë parasysh dallimet që ndodhin ndërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Këto përshtatje barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin t në kuadër të procesit relevant tarifor.

Po ashtu sipas afateve të përcaktuara nga ZRrE janë përgatitur dhe janë dorëzuar dokumentet në ZRrE sipas orarit indikativ dhe kërkesave të ZRrE-së:

- Modeli i ZRrE për Përshtatjet Vjetore për vitin 2021,
- Lista e Projekteve Kapitale të Realizuara 2021 dhe planifikimi për vitin 2021 me kërkesat për projekte të reja.

Në aspektin e tarifave vend të veçantë ka dhe Modeli për Planifikim Financiar Afatgjatë. Gjatë vitit 2021 është populluar Modeli Financiar me të dhënat e fundit të kompanisë duke na dhënë kështu pasqyra shumë të rëndësishme mbi kompaninë dhe planifikimin për vitet në vijim.

Gjatë vitit 2021 është shfrytëzuar sistemi elektronik i Arkivit krahas arkivimit fizik të dokumenteve duke mundësuar efikasitetit më të lartë në punë, dhe duke mundësuar shfrytëzimin e sistemit edhe nga ana e Menaxhmentit. Në harmoni me kërkesat ligjore është rregulluar Arkiva qendrore duke e përfshirë arkivin aktiv, ndërkëq arkiva pasive është rregulluar dhe i gjithë dokumentacioni është vendosur sipas standardeve të këruara dhe në harmoni me politikën dhe procedurën për arkiv.

KOSTT beson që përgjegjësia dhe transparenca ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit janë ndër parimet bazë në përbushjen e mandatit si institucion publik derisa reputacioni është një nga asetat e rëndësishme strategjike i cili ka ndikim në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e besimit të palëve interesit.

KOSTT nëpërmes Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun (ZKRP) planifikon dhe zbaton rrjedhat e komunikimit si dhe ndërmerr aktivitete të vazhdueshme në mbështetje të objektivave strategjike të kompanisë të përcaktuara me Planin e Biznesit, nëpërmes veprimeve dhe formave të përcaktuara sipas Strategjisë së Komunikimit dhe procedurave për komunikim.

Viti 2021 është karakterizuar me disa aktivitete për shënimin e 15 vjetorit të themelimit të KOSTT të cilat kanë qenë në mbështetje të objektivave strategjike 9 dhe 10 të kompanisë. Gjashtë muaj pas pavarësimit të Kosovës/KOSTT nga Blloku SMM dhe fillimit të operimit të suksesshëm si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut AK, me 1 korrik 2021 në praninë e autoriteteve më të larta shtetërore si dhe autoriteteve ndërkombëtare në një ceremoni solemne **KOSTT ka shënuar 15 vjetorin e themelimit**.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 15 vjetorit të themelimit nën organizimin e ZKRP, KOSTT gjithashtu **organizoi Forumin e parë të nivelit të lartë në Kosovë ku është diskutuar për herë të parë roli**



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

faqe 67 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

**I gruas në sektorin e energjisë në vend.** Në Forumin virtual me temë “Roli i gruas në sektorin e energjisë – përvoja e KOSTT” i cili u mbajt me datë 25 Qershor 2021, pjesë të panelit të diskutimit ishin autoritete të larta të Qeverisë së Kosovës, Parlamentit të Kosovës, MCC dhe ekspertë të fushës vendor dhe ndërkontëtar.

Në këtë drejtim gjithashtu janë realizuar dhe lansuar dy video projekte “**Rrugëtimi I KOSTT drejt ENTSO-E**” si dhe video projekt i përfshirë fuqizimin e gruas në sektorin e energjisë “**Inspirohu në energji**” duke kontribuar kështu në avancim të agjendës për barazi gjinore në sektorin e energjisë.

Në mbështetje të objektives strategjike 11 KOSTT ka ndërmarrë disa aktivitete në shërbim të komunitetit duke promovuar gjithpërfshirjen sociale në vendin e punës si dhe mbështetjen për mirëqenien dhe shëndetin e komuniteteve në nevojë dhe komuniteteve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, nëpërmes ZKRP KOSTT ka vazhduar me aktivitete të përgjegjësisë shoqërore korporative (CSR) edhe me përfaqësim në Bordin e “Kosovo CSR Network” si rrjeti i parë i bizneseve i themeluar me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik duke zbatuar praktikat më të mira të CSR.

KOSTT në vazhdimësi zbaton politikë të integruar të komunikimit me qëllim të ruajtjes së cilësisë, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së informative derisa në përputhje me qasjen transparente si një nga vlerat themelore të kompanisë, KOSTT zbaton strategji proaktive në informimin e palëve të interesit dhe opinionit në përgjithësi në lidhje me zhvillimet në kompani. Gjatë vitit 2021, zhvillimet në sektorin e energjisë kanë qenë në qendër të vëmendjes së opinionit publik ku edhe interesimi i mediave dhe palëve të tjera të interesit karshi zhvillimeve ka qenë i theksuar, dhe në këtë drejtim në përputhje me qasjen transparente janë ofruar informacione në vazhdimësi.

Sipas mandatit të përcaktuar, gjatë vitit 2021 ZKRP në emër të KOSTT ka zbatuar strategji proaktive e cila ka ndikuar në imazhin e kompanisë tek palët e interesit, janë implementuar aktivitete të vazhdueshme në shërbim të informimit të opinionit publik në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e KOSTT, vizibilitetit të kompanisë, janë realizuar publikime si dhe janë organizuar ngjarje.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 68 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 8. Realizimi i Projekteve Kryesore Kapitale Gjatë Vitit 2021

Duke u ndërlidhur me përgjegjësitet mbi zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe detyrimet ligjore, në bazë të licencës së dhënë, bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullat e ZRrE /Nr.13/2017, KOSTT ka përgaditë dhe ka punuar në realizimin e Planin Zhvillimor dhjetëvjeçar të Transmetimit 2013-2022 (PZhT) dhe Planin Pesëvjeçar Investues 2018-2022 (sipas periudhës tarifore), i cili paraqet bazën e planifikimit të zhvillimit dhe të investimeve kapitale të KOSTT-it, të cilat plane aprovohen nga ZRrE.

Plani Zhvillimor dhe ai Investues përmban listën e projekteve për zhvillimin dhe përforcimet që pritet të ndodhin në rrjetin e transmetimit të Kosovës për periudhën 5 deri në 10 vite me objektivat si në vijim:

- Ndërtimin e kapaciteteve të reja transformuese dhe transmetuese,
- Përkrahjet e ngarkesës/nënstacionet e reja 110/10(20)kV ;
- Përforcimin e kapaciteteve ekzistuese transformuese dhe transmetuese,
- Ri-vitalizimi i pajisjeve ekzistuese të tensionit të lartë (linja dhe nënstacione)
- Zhvillimi i sistemeve mbështetëse të sistemit të transmetimit.
- Projekte tjera

Opsonet e zhvillimit dhe planifikimit investiv të rrjetit janë bazuar edhe në Kodin e Planifikimit dhe në rregullat e përgjithshme planifikuese të rekomanduara nga ENTSO-E. Metodologjia deterministikë (përcaktuese) e cila mbështetet në kriterin e sigurisë N-1, që paraqet metodologjinë themelore të zbatuar në këtë plan, me qellim të identifikimit dhe përcaktimit të listës së projekteve të nevojshme për zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Gjithashtu metodologjia probabilistike është shfrytëzuar duke u bazuar në metodologjinë e publikuar nga ENTSO-E ne lidhje me përcaktimin e kost/benifitit të projekteve infrastrukturore të transmetimit. Kryesisht kjo metodologji është përdor në projektet që ndërlidhën me përforcim të kapaciteteve të rrjetit transmetues.

Gjatë vitit 2021 është punuar në drejtim të realizimit të objektivave të KOSTT pë zhvillimin e infrastrukturës energjetike gjegjësisht është vazduar puna në përbylljen e projekteve të filluara në vitet paraprake të parapara me buxhet dhe planin investues 2018-2022. Sa i përket investimeve në sistemin e transmetimit, projektet i kemi paraqitur të ndara në kategori:

- I. Projektet të cilat kanë përfunduar në vitin 2021 janë nën afat garantues njëvjeçar

Gjatë vitit 2021, saktësisht më datë 10.09.2021 ka përfunduar edhe pjesa finale e grupit të projekteve të finançuara nga BERZH si:

- Linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, NS Fushë Kosova,

Këto projekte tani e tutje janë nën monitorimin e tyre gjatë periudhës garantuese për ndonjë defekt eventual, i cili nëse paraqitet lajmërohet te kontraktuesi përmirësim dhe eliminim.



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 69 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

II. Grupi tjetër i projekteve janë ato të finançuara nga KOSTT dhe të nënshkruara gjatë vitit 2021. Këto projekte janë në fazën filloreste të implementimit janë dhënë më poshtë:

- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Kastrioti me transformator 40MVA dhe
- Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti

Projekti është nënshkuar në Maj 2021 dhe pritet të përfundoj në Maj 2023, është në fazën e përgatitjes së dizajnit dhe dokumentacionit për marrjen e kushteve dhe lejeve ndërtimore (sipas ligjeve) si dhe aplikimi për shpronësim dhe servitut në trasenë e planifikuar të projektit, në institucionet përkatëse dhe në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

- Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova

Gjatë vitit 2021 është iniciuar dhe perfunduar procesi i prokurimit, dhe nënshkrimi i kontratës.

Në vazhdim, është dhënë tabela e realizimit të buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2021:

1	Projektet me BERZH LOT 1 – nënstacionet GIS No.45552
Buxheti	20,000,000.00€
Financues	BERZH (kredi)/KOSTT
Vlera e kontrates	Me TVSH 19,614,980.67 €
Data e fillimit	16.09.2016
Data e perfundimit	28.02.2020
Kontraktues	ABB (Italy & Croatia)
Buxheti i shpenzuar deri në fund të vitit 2021	16,651,887.02 €
Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2021	00.00€
Realizimi:	(i) Progresi  Viti 2021 në projekti LOT1 karakterizohet me realizimin e punëve rreth eliminimit të vërejtjeve, të dhëna nga komisioni për pranim Teknik intern, të cilat janë përmirësuar nga ana e kontraktorit për Nënstacionet e reja:



## RAPORT VJETOR 2021

DT-FI-010

ver. 1.0

fazë 70 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

	<p>Për NS. Prishtina 6, nuk janë realizuar qëllimisht ende pagesat përfundimtare në vlerë rreth 100,000.00 EURO, për shkak se kontraktuesi e ka për obligim dorëzimin e raportit final të projektit, dhe duhet të dorëzoj faturat finale.</p> <p><b>Rreziku dhe pengesat</b></p> <p>Situata pandemike ka paraqitur vështirësi dhe pengesa, për shkak se ekspertët e kontraktuesit dhe konsulentit janë ndërkombe të Italia, Kroacia dhe Zvicra, të cilët kanë pasur restriksione të udhëtimit.</p>
<b>2.</b>	<p><b>Projektet me BERZH LOT 2 – transformatorët e fuqisë</b></p> <p>4,000,000.00€</p>
Financues	BERZH (kredi)/KOSTT
Vlera e kontrates	Me TVSH: 3,880,401.28€
Data e fillimit	16.09.2016
Data e përfundimit	30.11.2020
Kontraktues	Hyundai/Balkan Petrol
Buxheti i shpenzuar deri në fund të vitit 2021	3,348,462.24 €
Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2021	11,133.52 €
Realizimi:	<p>(i) <b>Progresi</b></p> <p>Projekti ka përfunduar periudhën e afatit garantues gjatë 2021 Projekti është përmbyll teknikisht dhe financiarisht</p> <p><b>(ii.) Rreziku dhe pengesat</b></p> <p>Situata pandemike ka paraqitur vështirësi dhe pengesa, për shkak se ekspertët e kontraktuesit janë ndërkombe të Bulgaria, të cilët kanë pasur restriksione të udhëtimit.</p>
<b>3.</b>	<p><b>Projektet me BERZH LOT 3 – Linjet transmetuese</b></p> <p>7,663,246.33 €</p>
Financues	BERZH/KOST T
Vlera e kontrates	Me TVSH 7,663,246.00€



## RAPORT VJETOR 2021

**DT-FI-010**

ver. 1.0

faqe 71 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Data e fillimit	03.10.2016
Data e përfundimit	31.08.2021
Kontraktues	Romelectro
Buxheti i shpenzuar deri ne fund të vitit 2021	6,460,710.16 €
Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2021	186,584.98 €
Realizimi:	<p><b>(i) Progresi</b></p> <p>Viti 2021 kryesisht ka qenë përqëndrimi në realizimin e punëve dhe përfundimin e atyre ndërtimore dhe ato instaluese në:</p> <p><u>1 Linja Ajrore/Kabllore 110kV NS. Fushë Kosova</u></p> <p>Gjatë vitit 2021, është realizuar pjesa finale e mbetur e kontratës pjesa e ndërtimit të linjës së dy-fishtë ajrore/kabllore për kyçje të NS. Fushë Kosova.</p> <p>Kjo pjesë e linjës ka pasur vonesa si rezultat i realizimit të procedurave të shpronësimit dhe servitudit dhe lejeve ndërtimore, pastaj projekt për një kohë është pezulluar përkohësisht nga Gjykata e Komunës Graçanisë për shkak të ankesave të pronarëve, ankesat dhe rezistencat nga pronarët tjerë, punë të cilat është dashur të kryhen me asistim të policisë, si dhe pengesat për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID19.</p> <p>Përfundimisht, projekt i është përfunduar me sukses më datë 31.08.2021, si dhe është bërë energjizimi i tij.</p> <p>Aktualisht kontraktuesi është duke u marrur me përmirësimin e vërejtjeve sipërfaqësore të dhëna nga komisioni për pranim Teknik intern i KOSTT-it.</p> <p><b>(ii) Rreziku dhe pengesat</b></p> <p>Realizimi i projekteve ka qenë i vështirësuar dhe në risk të lartë për shkak të situatës së COVID 19, dhe përshkak të problemeve pronësoro-juridike me pronarët.</p>
4.	<b>Administrimi dhe mbikëqyrja e Marrëveshjes së Kyçjes me SOWI -LLC për Parkun Energetik me Erë Selac 1, Selac 2 dhe Selac 3,</b>
Buxheti	Asetet e vleresuara të Kyçjes 4,398,500€



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 72 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Financues	Investitori SOWI
Vlera e kontrates	N/A
Data e fillimit	2018
Data e perfundimit	Q3 2021
Kontraktues	NOTUS
Buxheti i shpenzuar deri në fund të vitit 2021	N/A
Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2021	N/A
Realizimi:	<p><b>(i) Progresi</b></p> <p>Gjatë vitit 2021 janë mbikëqyrë punët ndërtuese të Aseteve të kyçjes, konform Marrëveshjes së kyçjes.</p> <p>Stafi i KOSTT ka përcjell punët në teren për ndërtimin e Aseteve të Reja të transmetimit , konform Marrëveshtjes së Kyçjes, ka marrë pjesë në testimet dhe mbikëqyrje deri në përfundimin dhe energizimin e këtyre aseteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Linja 110 kV që lidhë NS Selaci me NS Vushtrria 1 është energizuar më datën 29.07.2021;</li> <li>Më datën 04.10.2021 është marrë certifikata për fillimit të operimit të gjeneratorëve</li> <li>Pas përbilljes së plotë të obligimeve konform Marrëveshjes së Kyçjes gjeneruesi mund ti kaloj Asetet e Kyçjes në pronësi të KOSTT, siç parashihet në marrëveshje.</li> </ul> <p><b>(ii) Rreziku dhe pengesat</b></p> <p>Ka probleme me pronarë, për zgjidhjen e të cilave përgjegjës është investitori.</p>
Emri projektit	Konvertimi i nënstacioneve nga tensioni nga 10kV në 20kV
Buxheti	400,000.00 €
Financues	KOSTT
Vlera e kontrates	N/A
Data e fillimit	30.11.2020
Data e përfundimit	31.12.2021



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 73 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Kontraktues	N/A
Buxheti i shpenzuar total	N/A-
Buxheti i shpenzuar gjate vites - 2021	-N/A
Realizimi:  (i.) Progresi  (ii.) Rreziku dhe pengesat	<p>(i.) Progresi</p> <p>Gjatë vitit 2021 me kërkesën e KEDS është iniciuar projekt i konvertimit të nënstacioneve prej 10kV në 20kV , I cili projekt do të jetë afat gjatë . Pas analizimi të situatës nga ana e komisionit të përbashkë KOSTT/KEDS në rrjetin e distribuimit dhe transmetimit ,KEDS ka filluar projektin “Konvertimi i nivelit të tensionit nga 10kV në 20kV” ku në bazë të kësaj KOSTT duhet përgaditur fushat transformatorike për nivel 20kV në këto nënstacione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• NS Prishtina 2;</li> <li>• NS Prishtina 3;</li> <li>• NS Prishtina 5;</li> <li>• NS Prishtina 7;</li> <li>• NS Drenasi 2.</li> </ul> <p>KOSTT (DOT) është në proces të prokurimit të kthinave të reja transformatorike 20 kV të transformatorëve të shpenzimeve vetanake ( gjithsejt 13 kthina) si dhe rezistorëve të neutrit cilat nuk janë të parapara të operojnë në nivelin 20 kV. -</p> <p>Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar punët në NS 110/10(20) kV Prishtina 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Janë kryer injektimet dhe testimet ne primar dhe sekondar te TR 1 ne NS Prishtina 2 ku pas testimeve është bërë energjizimi i 20kV i TR 1 në NS Prishtina 2.</li> <li>• Vazhdimin i punëve do të jetë për konvertimin në 20kV të TR 3 në NS Prishtina 2.</li> <li>• Në NS PR 3 janë duke u zhvilluar punimet në zhvendosjen e TR2 ekzistuesit 110/10kV dhe përgaditjen e terenit për instalimin e TR të bartur nga NS Peja 2 110/10(20)kV - 40MVA</li> </ul> <p>(ii) Rreziku dhe pengesat</p> <p>Furnizimi në kohë me fusha transformatorike 20kV.</p>
Emri projektit	Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Kastrioti
Buxheti	4,956,000.00 €



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

faqe 74 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Financues	KOSTT
Vlera e kontratës	4,705,715.97 €
Data e fillimit	Prill 2021
Data e përfundimit	Prill 2023
Kontraktues	ABB Power Grids Zagreb d.o.o.
Buxheti i shpenzuar gjate vitit 2021	706,257.39€
Realizimi: (i.) Progresi (ii.) Rreziku dhe pengesat	<p>(i.) Progresi</p> <p>Është nënshkruar kontrata më 30.03.2021. është paguar Avansi dhe fillimi efektiv i kontratës. Projekti është financim nga buxheti I KOSTT-it Nënstacioni NS110/35/10(20)KV Kastrioti</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjatë periudhës 2021 janë komentuar dhe aprovuar dizajni i ndërtesës, pajisjeve të përfshira në kuadër të LOT 1.</li> <li>Eshtë kompleteura e dokumentacioni nga ana e kontraktorit (bazuar ne specifikim teknik ) për aplikim në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ,për kushte ndërtimore si dhe aplikimi në të gjitha institucionet relevante për pëlgjime.</li> <li>Gjatë vitit 2021 është realizuar vetëm pagesa e avansit 15%</li> </ul> <p>(ii.) Rreziku dhe Pengesat</p> <p>Realizimi i qasjes nga Komuna. Procesi i shpronesimit dhe lejes ndërtimore.</p>
Emri projektit	Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT5
Buxheti	1,534,000€
Finacues	KOSTT
Vlera e Kontratës	1,166,590.40 €
Data e Fillimit	Maj 2021
Data e përfundimit	Maj 2023.
Kontraktues	Ukab .sh.p.k
Buxheti i shpenzuar total	174,988.56€
Buxheti i Shpenzuar gjatë TM3	00.00€
Realizimi:	

(i.) Progresi	(i.) Progresi
(ii.) Rreziku dhe pengesat	<p>Është nënshkruar kontrata më 28.05.2021. është paguar avansi që është edhe fillimi efektiv i kontratës.</p> <p>Projekti është në fazën e përgatitjes së dizajnit dhe dokumentacionit përmarrjen e kushteve dhe lejeve ndërtimore (sipas ligjeve) si dhe aplikimi për shpronësim dhe servitut në trasenë e planifikuar të projektit, në institucionet përkatëse dhe në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës •</p>
(ii.) Rreziku dhe Pengesat	<p>Realizimi i qasjes nga Komuna. Procesi i shpronësimit dhe lejes ndërtimore.</p>

Tabela 13 Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2021

Realizimi i investimeve kapitale në total për vitin 2021 është si vijon:

Investimet kapitale të planifikuara janë 6,004,646 ndersa të realizuar janë 2,937,621 në përqindje 48.92%

Disa prej projekteve të parapara për të filluar implementimin si:

- Projekti (ID/011):NS Malishevë AIS 220/35/10(20)kV
- Furnizimi dhe instalimi i Transformatorëve të fuqisë për NS. Malisheva dhe NS. Fushë Kosova

ëto projekte nuk kanë filluar pasi që nga viti 2020, janë nën proces ankimor në Organin Shqyrtues të Prokurimit për shkak të ankesave të paraqitura gjatë procesit të prokurimit, dhe janë duke pritur vendimin nga OSHP, për të proceduar tutje.

Gjatë vitit 2021 janë Përgaditur specifikimet teknike për projektet e mëposhtme dhe janë dërguar në prokurim në kuartalin Q4 për procedura të mëtejme:

- “Furnizimi dhe instalimi i Shunt Reaktorit të ndryshueshm 100MVA në NS Ferizaj 2”;
- Projektin për sëndërtimin e sistemit SCADA / EMS në Qendrën Nacionale Dispecerike ;

Këto projekte aktualisht janë shtyer për shkak të situatës financiare të krijuar në KOSTT nga mungesa e të hyrava për mbulimin e obligimit të humbjeve të sistemit (Energjia e konsumit në pjesën veriore të Kosovës), krizës financiare për shkak të rritjes enorme të çmimit të energjisë elektrike në treg dhe problemet me inkasim të hyrave nga KESCO dhe KEDS.

- Projektet e fazës së VI dhe VII – Financim nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW të realizimit të projekteve.

Sipas planit investues ky grup i projekteve është planifikuar të financohet me huamarrja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, KfW dhe KOSTT në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Por për shkak të mos nënshkrimit të marrëveshjes për kredi, realizimi i këtyre projekteve shtyhet për vitet në vijim.

Në diagramin më poshtë janë ilustruar implementimi i projekteve si dhe ato në pritje për tu implementuar:




Figura 13

Implementimi i projekteve si dhe ato në pritje

Viti 2021 rezulton me nënshkrim të Marrëveshjeve të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit të aplikuesve të paraqitura si më poshtë konform Metodologjisë së Taksave të Kyçjes:

- Dukagjini Solar SHPK – për SGJED “Trstenik” (96MW) dhe “Sverke”(96MW), nënshkrim i MK me 05.03.2021;
- SOLAR ENERGY GROUP EUROPE Sh.p.k për SGJED “SEGE “me kapacitet 150MW nënshkrimi i MK me datën 23.02.2021 ;
- Aplikuesi EV WIND Sh.p.k për Stacionin Gjenerues Energjetik me Erë 30/110kV ”Zatriq”, i cili ka pranuar ofertën në prill të vitit 2018 dhe ka marrë Autorizimin Preliminar nga ZRRE për kapacitet 64,8 MW është në pritje të nënshkrimit të Marreveshjes së Kyçjes.

Sipas Metodologjisë së Taksave të kyçjes dhe Marrëveshjes së kyçjes për nënshkruerit janë përgaditur edhe specifikimet teknike për Astete e Kyçjes .

Pas pranimit të letrës nga ZRRE me 07.04.2021 ku rekomandohet që para se të nënshkruhet Marrëveshja e Kyçjes në mes të KOSTT dhe Aplikuesit, Aplikuesi fillimisht duhet të pajiset me Autorizim preliminar nga

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 77 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Bordi i ZRRE, janë stopuar finalizimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Kyçjes. Për aplikuesit e mëposhtëm janë përgaditur dhe dorëzuar “Informatat Teknike” për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit:

- Aplikuesin CICAVICA WIND FARM 1 sh.p.k. të Stacionit Gjenerues Energjetik me Erë “CICAVICA WIND FARM 1 ” me kapacitet 116,6 MW
- Aplikuesin “KATKOS “ L.I.c për Stacionin Gjenerues Energjetik me Diell 33/110kV “ KLINAS ” 105MW(ac);
- Aplikuesin “KATKOS “ L.I.c për Stacionin Gjenerues Energjetik me Diell 33/110kV “Junik ” 50MW;
- Aplikuesin Elektrostublla sh.p.k për “Jasenovik” SGJEE me kapacitet 138 MW dhe SGJED 32MW në total 170MW ;
- Aplikuesin “JAHA SOLAR” SH.P.K për SGJED “Ramjan” 104,8MW;

## 8.1. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin, përpjekjet e KOSTT-it, edhe më tutje do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike.

Përveç zhvillimeve që priten gjatë vitit 2022 në aspektin e operimit dhe tregut, bazuar në Planin e Biznesit 2022, KOSTT synon:

- Rifreskimin e politikave dhe procedurave në përputhje me rekomandimet e ZKA
- Rifreskimin e statutit të kompanisë

Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të sistemit në KOSTT gjatë vitit 2022, do të jenë:

- Ngritura e cilësisë së Operimit të KOSTT si LFC Zonë në kuadër të LFC Bllokut AK, e krijuar nga KOSTT dhe OST e Shqipërisë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të nevojshme si për RSC (Regional Security Coordination), EH (electronic highway), EAS (energy awarness system), VP (Verification Platform), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination), TP (transparency platform), SMTA (short- &medium-term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), etj.
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST;
- Implementimi i procedurës për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 78 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

- Implementimi i Tregut Balancues sipas legjislacionit ne fuqi;
- Përgaditjet për Operimin e tregut një ditë para dhe gjatë ditës ALPEX. Operimi i tregut të liberalizuar në përputhje me ligjin e ri të energjisë elektrike
- Pjesëmarrje në iniciativat dhe grupet punuese rajonale si EMI, SMTA, SCC, SOC dhe UCSI
- Investimi në platforma softuerike, që mundësojnë pjesëmarrje në operimin paralel interkonektiv në nivel pan evropian si RSCI (Regional Security Coordination), VP (Verification Platform), EH (electronic highway), TP (Transparency Platform), SMTA (short- &medium-term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), EAS (energy awerness system), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination).
- Ringritja e infrastrukturës ekzistuese të sistemit SCADA/EMS që konsiston në:
  - Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit të transmetimit nga Qendra Nacionale Dispeçerike Kryesore dhe Emergjente;
  - Përgatitja e infrastrukturës teknike për qasje në platformën e EAS (Energy Awerness System) në kuadër të ENTSO-E.
  - Përfundimin e studimit në lidhje me krijimin e një zone tregtare Kosovë-Shqipëri
  - Përshtatja e planit zhvillimor afatgjatë në përputhje me strategjin e aprovuar nga Qeveria e Kosovës

Modi ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin në kuadër të AK LFC Bllokut si dhe me OST-të e interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E.

Gjatë vitit 2022 do të bëhet raportimi i derogimeve të vendosura në marrëveshjen e kyçjes. Grupi prej ekspertëve, i krijuar nga ENSTO-E (PG KOSTT), do të vazhdojë të bëjë monitorimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave të vendosura nga ENTSO-E, për operim paralel të TSO-ve. Kërkesat janë kryesisht teknike, që ndërlidhen me sigurinë e operimit të sistemit, shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kritereve nga paketi i tretë i energjisë të KE.

Objektivat e monitorimit nga ENTSO-E janë:

- o Siguria e operimit të sistemit elektroenergetik nga aspekti i rrjetit;
- o Siguria e Shërbimeve ndihmëse;
- o Ndryshimet e nevojshme rregullative që kërkohen nga paketi i tretë i legjislacionit të Komisionit Evropian për Energji

Duke i përcjellë zhvillimet e reja në sektorin e energjisë respektivisht, procesin e integrimeve evropiane, KOSTT duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të kërkesave dhe standardeve që rrjedhin nga këto procese. Plotësimi i standardeve gjithashtu është kërkesë e procesit të zhvillimit të projekteve voluminoze në KOSTT.

	RAPORT VJETOR 2021	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 79 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Me zhvillimin e mëtejshmë të biznesit jo të rregulluar- komercializimin e shërbimeve nga lëmi i telekomunikimeve, KOSTT synon që të realizoj të hyra më të larta se në vitin 2021.

Për vitin 2022 pritet që KOSTT të nënshkruaj edhe marrëveshje tjera për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre) duke synuar që të kalojë vlerën 300,000.00 euro. Me realizimin e këtij synimi KOSTT duhet të përmbrush edhe disa kërkesa tjera të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, do të fillojnë punimet lidhur me projektin Ballkans Digital Highway, bazuar në assistencën teknike të aprovuar në aplikimin e paraqitur në WBIF (Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor). Zhvillimet e planifikuara në këtë projekt për vitin 2021 janë shtyrë për vitin 2022.

#### **8.1.1. Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen:**

Liberalizimi i tregut dhe mundësitet e integrimit në tregun e përbashkët rajonal

Ndërsa sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë elektrike në Kosovë është funksionimi i tregut efektiv konkurrues në sektorin e energjisë elektrike dhe integrimi në tregun e përbashkët rajonal.

Me udhëzimin e ZRrE-së për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, është përcaktuar mënyra, kushtet dhe koha e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Nga 1 prill 2017, tregimi me shumicë i energjisë elektrike bëhet në çmimë të de-rregulluara kurse de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundor do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale.

Përkundër masave të ndërmarra drejt liberalizimit të tregut në Kosovë, deri tani mungon konkurenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë disa furnizues të licencuar për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, aktualisht vetëm KESCO bën furnizimin e të gjithë konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të pa rregulluar ndërsa të tjerët ende nuk janë aktiv në treg.

Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm pesë konsumatorë të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmetimit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse Sharr-Cemi, Trepça, PEE Selaci dhe PEE Kitka në nivelin 110kV), ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal.

Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar:

- Janë rishikuar Rregullat e Tregut të cilat janë miratuar nga ZRrE në tetor 2018;
- Janë përpiluar procedurat e nevojshme për të mbështetur proceset në këtë drejtim.

Në përputhje me “Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike” (të përpiluar nga KOSTT dhe miratuar nga ZRrE) që përcakton parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike, Operatori i

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 80 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Tregut ka vazhduar të organizojë Ankandet ditore për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet si dhe blerjen e energjisë balancuese duke zbutur devijimet e mëdha në sistem të shkaktuara pas rënies së njësisë gjeneruese. Gjithashtu gjatë këtij viti Operatori i Tregut ka bërë prokurimin e rezervave balancuese për Rezervën Manuale të Restaurimit të Frekuencës (mFRR) në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuar në treg.

### **8.1.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit**

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtën e ndërrimit të Furnizuesit e ka çdo konsumator fundor, familjar ose jo familjar, ndërsa përgjegjësia për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit i është dhënë Operatorit të Tregut. Këtë përgjegjësi Operatori i Tregut e ushtron sipas Rregullave të Tregut dhe Rregullës për Ndërrimin e Furnizuesit të miratuar nga ZRrE.

Në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të ZRrE-së, përcaktohen kriteret dhe afatet kohore të de-rregullimit të çmimit për furnizimin e konsumatorëve fundorë, ku në mes tjerash parashihet edhe de-rregullimi i çmimit duke u bazuar në nivelin e tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët.

Bazuar në këtë KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit, në përputhje me Rregullat e Tregut dhe në afatet kohore të përcaktuara në udhëzuesin e ZRrE-së. Megjithatë duke pasur parasysh afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundohet procesi i transferimit të konsumatorit dhe numrin e konsumatorëve që kanë të drejtën e ndërrimit të furnizuesit e që në të ardhmen ky numër pritet të rritet, atëherë KOSTT është duke planifikuar sigurimin e një softueri që ky proces të kryhet në mënyrë automatike dhe të jetë i auditueshëm.

#### Integrimi rajonal

Si rezultat i angazhimeve të vazhdueshme, KOSTT ka arritur të shënojë përparime drejt integrimit në mekanizmat rajonale dhe është:

1. Pjesëmarrës në ITC mekanizmin për tranzit
2. Themelues dhe aksionar i SEE CAO
3. Pjesëmarrëse nga 1 Qershori 2021 në mekanizmin e pagesave të Shkëmbimeve të qëllimshme dhe të Paqëllimshme ndaj Zonë SInkrone të Evropës Kontinentale

Integrimet në tregjet rajonale janë obligim që kërkohet të përbushet nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe njëra ndër objektivat kryesore të përcaktuara në Strategjisë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu integrimi rajonal është ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT-it që përkundër angazhimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, edhe më tutje vazhdon të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integrimit në mekanizmat rajonale.

## 8.2. Sfidat e KOSTT

Sfidat për KOSTT, përveç atyre të cilat dalin nga Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës janë adresuar për arritjen e objektivit të integrimit në tregun rajonal të energjisë, e që lidhen me:

- Operimin e KOSTT-it si zonë rregulluese në bllokun AK
- Adoptimet e kërkesave dhe standardeve në përputhje me kodet e rrjetit dhe të marrëveshjes SAFA ;
- Integrimi i BRE-ve dhe balansimi i sistemit elektroenergjetik;
- Fillimi i operimit të bursës së energjisë ALPEX;
- Integrimi në tregun rajonal të energjisë
- Performimi i operimit të sistemit konform Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E (kërkesat e vendosura në Katalogun e Masave të Projekt Group);
- Balancimi i Sistemit në kohë reale duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e produkteve balancuese të nevojshme;
- Përballimi i imbalanceeve në kohë reale të shkaktuara nga BRE, veçmas me fillimin e operimit të kapaciteve të reja prej 105 MW nga BR;
- Ndikimet hidrologjike dhe teknike në KESH që zvogëlojn kapacitetin e rezervës manuale dhe pamundësinë e aktivizimit të mFRR (rregullimit terciar) në kohëzgjatje më të madhe;
- Sigurimi i sasisë së nevojshme të aFRR (rregullimi sekondar), në përputhje me rritjen e kërkesës perte BRE-eve, duke pasur për bazë faktin se brenda Kosovës nuk ka mundësi;
- Mos adresimi i zgjidhjes së furnizuesit me energji elektrike të pjesës veriore të Kosovës;. KOSTT ka obligim sipas licencës që të mbuloj humbjet e sistemit që janë konsumi i energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës. Sipas licencës për këto kosto duhet të sigurohen të hyrat e lejuara për mbulimin e këtyre kosotove nga tarifat e energjisë elektrike. Në vitin 2017 me vendim të gjykatës ZRRE ka pezulluar të hyrat për këtë kategori të shpenzimeve. Në vitin 2021 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerr një rekomandim ku autorizohet KOSTT ti mbuloj këto humbje nga buxheti vetanak të cilat do ti kompensohen nga dividenta apo ndonjë mekanizëm tjetër. Në vitin 2021 kjo kosto ka arri vlerën mbi 41 Milion Euro për shkak të rritjes enorme të çmimit të energjisë elektrike në treg. Kjo situatë ka sjellë KOSTT-in në situatë të veshtirë financiare si nga aspekti i rrjedhës së parasë po ashtu nga aspekti i afarizimit në tërsëi. Nëse nuk gjendet zgjidhje për vitin 2022 që të kompensohen kostot, KOSTT nuk mund ta kryej këtë obligim dhe aktivitetin afarist të kompanisë. Gjithashtu pamundësia e balancimit të sistemit nga KOSTT për shkak të pamundësisë së blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në sistem do ta rrezikoj KOSTT-in në raport me marrëveshjen e kyçjes ndaj TSO-ve të Evropës Kontinentale.
- Krijimi i kushteve për mundësimin e tregtimit ndërkufitar KOSTT-EMS.
- Nevoja për përshtatjen e Mekanizmit Balancues në kontekst të sjelljes korrekte të palëve tregetare ndaj programeve të deklaruara;
- Përballimi i fyteve të ngushta në rrjetin e transmetimit, veçenarisht në transformim, nëse vazhdon trendi aktual i rritjes së kosumit;
- Ndikimi i mundshëm në furnizim të pandërprerë gjatë fazave të kalimit në nivelin 20kV për shkak të kërkesave të KEDS-it;

- Domosdoshmëria e rritjes së stafit punues në Operimi të Sistemit dhe tregut shkaku i rritjes së kërkesave dhe detyrave pas fillimit të operimit të KOSTT si LFC Zonë e pavarur në kuadër të AK LFC Bllokut;
- Për stafin e operimit të sistemit mundësimi i trajnimeve dhe pjesëmarrjes në grupet punuese të ENTSO-E, me qëllim të aftësimit për kryerjen e funksioneve nën rrëthanat e operimit të KOSTT si LFC Zonë e pavarur;
- Ndjikimi në operim efikas të sistemit nga funksionimi adekuat i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll (SCADA/EMS), telekom, TI dhe e tregut;
- Integrimi në FTP platformat në kuadër të ENTSO-E (EHV, EAS, OPC, RSC, TP,etj), të cilat janë pjesë e kërkesave të listuara në Katalogun Masave të ENTSO-E.
- Implementimi i marrëveshjes multilaterale KOSTT-ENTSO-E i njohur si mekanizmi i kompensimit

KOSTT si operator i tregut do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe integrimin në mekanizmat rajonal. Në këtë drejtim aktivitetet e zhvilluara janë në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës, kërkesat që dalin nga legjisacioni primar i sektorit të energjisë, kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe MSA-së ndaj hapjes së tregut të energjisë, si dhe në pajtim me Direktivat e Komisionit Evropian.

KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE, megjithatë mbetet sfidë konkurenca në tregun me pakicë. Implementimi i marrëveshjeve për blerje të energjisë me BRE të cilat janë në operim ka filluar mirëpo rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të tyre paraqet sfidë në vete në aspektin e parashikimit dhe menaxhimit të fondit për BRE. Kështu që në fund të vitit 2021 ka filluar operimin komercial Parku energetik me erë Selaci 1 dhe Selaci 2 me kapacitet total 69.4 MW, ndërsa gjatë vitit 2022 pritet të filloj Operimin Komercial edhe Parku energetik me erë Selaci 3 me kapacitet total 34.7 MW. Rritja e kapaciteteve të BRE ka ndikim edhe në procesin e parashikimit adekuat të prodhimit sepse Operatori i Tregut është blerës i vetëm dhe mbulon 75% të imbalanceeve të BRE dhe këto imblance kanë ndikim në koston e fondit të BRE që mbulohet nga konsumatorët. Gjatë vitit 2021 çmimi e imbalancit është rritur shumë për shkak të rritjes së çmimit të energjisë në Bursa dhe kjo paraqet një sfidë për mirëmbajtjen e llogarisë balancuese.

Në aspektin e zhvillimit të tregut, do vazhdohet angazhimi rreth projektit për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri. Krijimi i Tregut të përbashkët Kosovë - Shqipëri është një hap drejt integrimit në tregun pan-evropian në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB 6.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurt me energji elektrike, KOSTT dhe OST si askionar të vetëm të Bursës së energjisë elektrike ALPEX synojnë që bëjnë operative këtë Bursë gjatë vitit 2022. Procesi i bashkimit të dy tregjeve do të vazhdojë në harmoni me planet e përpiluara të dy vendet. Por që të funksionojë bursa dhe të rritet volumi i tregtimit në Bursë duhet të ketë liberalizim të mëtejshëm të tregut të energjisë dhe kjo është një nga sfidat me të cilën do të përballemi në vitet në vijim.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 83 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

### 8.3. Aktivitetet tjera

Sipas planit për investimet kapitale, në vitin 2021 është përgatitur specifikimi teknik, respektivisht finalizimi i specifikimit teknik të përgatitur nga stafi profesional i KOSTT, dhe fillimi i procedurave të prokurimit për projektin Ndërrimi i Sistemit Ekzistues SCADA /EMS në QND dhe QNDE, si dhe realizimi i projekteve tjera që janë në vazhdimësi. Poashtu, është vazhduar me angazhimin për realizimin e projekteve të cilat janë në planin investiv të aprovuar si dhe do të vazhdojë përkushtimi për të identifikuar veprimet e nevojshme për ngritjen e nivelit te sigurisë kibernetike.

Në përputhje me një nga objektivat strategjike të KOSTT, që të përkujdeset për shëndetin e punëtorëve, pas implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore mendohet që të shkohet edhe me projekte tjera për mbrojtjen e punëtorëve në aspektin e shëndetit duke u bazuar në sigurimet tjera si në rast të aksidenteve personale për pjesën e punëtorëve të cilët punojnë në kushte të veçanta të punës.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave, KOSTT ka implementuar me përpikëri të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001:2015., ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë për qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të SIM KOSTT, në vitin 2021 është Ri-certifikuar për herë të 4 që nga viti 2010 me 3 Standarde të njoitura ndërkombëtarisht dhe atë Standardin për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015, standardin për Menaxhimin e mjedisit ISO 14001:2015 dhe standardin për Siguri dhe shëndet në punë ISO 45001:2018 të cilat janë integruar në SIM (Sistemi i integruar i menaxhimit)

Këto Standarde janë implementuar me përpikëri gjithmonë duke pasur përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Krahas zhvillimeve ndërkombëtare në fushën e standardeve si dhe kërkesave të reja për sigurinë e informacionit të ndërlidhura me sigurinë kibernetike, KOSTT në vitin 2021 ka planifikuar fillimisht plotësimin e të gjitha kërkesave dhe për këtë qëllim ka realizuar Projektin për angazhimin e një konsulencë e cila ka ndihmuar kompaninë në përgatitjen për certifikim me Standardin për sigurinë e informacionit ISO 27001:2013. Pasi që janë bërë përgatitjet dhe plotësimin e kërkesave për certifikim në dhjetor të vitit 2021 KOSTT është certifikuar edhe me standardin për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMS) ISO 27001:2013 e integruara në SIM së bashku me standarde tjera dhe kështu është bërë kompania e parë publike e certifikuar me këtë standard.

KOSTT në të ardhmen krahas zhvillimeve dhe kërkesave të reja planifikon certifikimin edhe me standarde tjera të cilat janë të nevojshme për kompaninë dhe të cilat gjithashtu do të integrohen në SIM së bashku me standarde tjera.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 84 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## 9. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- Pamundësia e performimit efektiv të operimit të KOSTT-it si zonë/bllok rregullues, përkatësisht implementimit të marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSO-E. Mundësia që për shkak të obstruksioneve nga Serbia, të hyrat nga alokimi i kapaciteteve dhe kongestionet në linjat interkonektive të mos realizohen për kufirin KOSTT-EMS. Si pasojë, kjo do të pengojë KOSTT dhe Kosovën në përmbushjen e zotimeve të 6 shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive.
- Vështirësitet e mundshme për balansim efikas të LFC Zonës së KOSTT, në rast të mos adresimit së furnizuesit për veriun e Kosovës. Nese nuk adresohet çështja e mbulimit të kostove të furnizimit të konsumit në pjesën veriore të Kosovës KOSTT nuk do të mund të balancoj sistemin sipas obligimeve të marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSOE dhe rregullatives përkatëse në vend që do të ketë pasojat e ndëshkimeve monetare për sjellje jo korrekte konform dispozitave të katalogut të masave, përveç ndëshkimit prej 5 milion euro që parashihet në Marreveshje dhe mbi të gjitha mundësitet e mos vazhdimit të marrëveshjes me ENSTO-E
- Risku rregulator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- Pagesat e imbalanceve të shkaktuara gjatë muajit dhjetor të gjitha palëve në treg dhe ENTSO-E
- Kompensimi i imbalanceve nga KESCO/KEDS
- Pagesa e borxheve ndaj KOSTT të palëve tregtare veçanarisht KESCO/KEDS
- Gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u gjithashtu paraqet kërcënim në zvogëlimin e performancës së furnizimit dhe kostot shtesë të zhvillimit
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjesë të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Rreziqet nga sulmet kibernetike në infrastrukturën e KOSTT me theks të posaçëm në Operimin e Sistemit Transmetues dhe tregut të energjisë elektrike.

Në mënyrë që të ulet ndikimi në secilin rrezik, janë të domosdoshme këto veprime:

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 85 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

- Krijimi i likuiditetit financiar në sektor në mënyrë që pagesat e detyrimeve të palëve të përfundojnë me kohë
- Vazhdimi i aktiviteteve rrreth evitimit të pengesave nga EMS në implementimin e plotë të marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSO-E;
- Mundësimi i transaksioneve tregtare në kufirin KOSTT-EMS. Kapacitetet e linjave Tranmestuese në kufirin ndërmjet zonave të pavarura rregulluese KOSTT (Republika e Kosovës) – EMS (Republika e Serbisë) nuk alokohet për shfrytëzim komersial për shkak se pala serbe nuk ka nënshkruar marreveshje interkonektive me KOSTT për alokimin e kapaciteteve transmetuese. Mungesa e këtij kapaciteti në treg shkakton kosto shtesë të shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë elektrike në Kosovë dhe në regjion për shkak të paraqitjes së kongjestioneve.
- Vazhdimi i aktiviteteve rrreth adresimit të furnizuesit për veriun e Kosovës,
- Anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Avancimi i operimit të sistemit të transmetimit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit, duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit, furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Fillimi i operimit të Bursës së energjisë elektrike Kosovë - Shqipëri (ALPEX). Vonesat në fillimin e operimit të ALPEX ndikojnë në vështirësimin e tregtimit të energjisë elektrike mes palëve, zhvillimin e tregut nacional, integrimin në tregun Kosovë- Shqipëri, integrimin në tregun regional dhe Evropian
- Implementimi eficjent i investimeve kapitale të KOSTT-it, duke përfshi edhe infrastrukturën për mbrojtjen nga sulmet kibernetike.

## 9.1. Sponsorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2021, KOSTT ka ofruar përkrahje financiare në vlerën totale prej 2,500 €, për:

KAEF      2,500.00 Euro

## 10. Raporti i Auditorit të Brendshëm

Raporti përfshinë rezultatet e aktiviteteve audituese të kryera gjatë vitit 2021.

Aktivitetet audituese janë kryer sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, manualit për auditim të brendshëm, procedurave dhe standardeve të cilat janë në funksion të auditimit të brendshëm, me qëllim garantimin e një eficience sa më të lartë në funksion të optimizmit të vlerës në Ndërmarrje.

Për vitin 2021, është përgatitur plani i auditimit të brendshëm dhe është prezantuar në nivelin e menaxhmentit ekzekutiv, i cili është përkrahur në përputhshmëri të plotë nga niveli menaxherial. Aktivitetet e auditimit janë zhvilluar sipas planit strategjik dhe vjetor të auditimit, në përputhje me

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 86 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

objektivat dhe natyrën e njësisë audituese. Në raportet e auditimit janë prezantuar aktivitetet, objektivat, vrojtimet, rreziku dhe rekomandimet.

Çdo aktivitet i Ndërmarrjes, të cilat ekzistojnë në kuadër të sistemit për menaxhimin e kontrollit dhe të cilësisë dhe të cilat janë në funksion të ligjeve, procedurave dhe rregullave përkatëse, duhet ti nënshtohen në mënyrë sistematike procedurave të auditimit të brendshëm.

Pjesë e rëndësishme e procesit për menaxhimin e funksionimit të auditimit është planifikimi i përdorur sipas këtyre kriterieve:

- **Objktivi i auditimit** – duhet të disponoj dëshmi të mjaftueshme dhe adekuate për të shprehur konkluzione dhe rekomandime efikase.
- **Metodologja e auditimit** – Përcaktimi i proceseve dhe procedurave që duhet të auditohen.
- **Vlerësimi i rrezikshmërisë** – matet nga devijimet (shmangjet) e ligjeve dhe procedurave.
- **Përcaktimi i prioriteteve audituese** – në bazë të:
  - Ndikimit financiar dhe material;
  - Rasteve urgjente me rrezikshmëri të lartë;
  - Ndërlikueshmërisë në proceset audituese;
  - Kohëzgjatja e fushës së auditimit;
  - Rëndësia për imazhin afarist të kompanisë dhe
  - Faktorët e brendshëm të cilët kërkojnë ekzaminim për çështje të caktuara.

## I. Misioni dhe Vizioni

### Misioni:

Të ndihmoj Ndërmarrjen që të mbaj lartë përgjegjshmërinë e menaxhimit gjatë përdorimit të parasë publike.

Vlerësimin mbi formën e përdorimit të fondeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë, duke kontribuar për qeverisje më të mirë nëpërmjet luftës kundër korruptionit.

### Vizioni:

Rritjen e rëndësisë së Auditimit, duke i kthyer rreziqet në rezultate.

Aspiratat, qëllimet që do ti arrijmë dhe objektivat që duhet t'i përbushim në të ardhmen, duke dhënë siguri të arsyeshme mbi llogaritë financiare dhe duke i ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të parasë publike.

## II. Qëllimi Strategik

- Është që të realizojmë vlerësimin e eficencës në menaxhimin e ndërmarrjes, duke kontribuar në shtimin e vlerës së tyre dhe forcimin e sistemit të kontrollit mbi to.
- Duke synuar që të aplikojmë metodologjinë dhe teknikat më të mira bashkëkohore, duke i rritur resurset njerëzore dhe teknike që ndikojnë në zgjerimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave.
- Ngritje më të lartë të imazhit të këtij shërbimi, duke krijuar siguri për mbrojtje të interesit të Ndërmarrjes.

### III. Çfarë ne duam:

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për kryerjen e auditimeve të këtyre aktivitetave siç janë:

- Financiar;
- Ligjor dhe rregullativ;
- Pajtueshmërisë së sistemeve;
- Përfomancës, etj.

Këto duhet të jenë në përputhje me rregullat në fuqi të cilat i përkasin fushës së auditimit të brendshëm. Ne japim vlerësim të pavarur mbi veprimitaritë e audituar dhe identifikojmë nëse ato janë zhvilluar me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet.

### V. Prioritetet kyçe

Si prioritete strategjik është rritja e eficencës së burimeve të auditimit të orientuar në analiza periodike, **burimet e përdorura = rezultatet konkrete** (niveli i përfomancës).

Për ketë, janë përcaktuar katër prioritete kryesore si në vijim:

- Ngritjen e procesit për vlerësimin e rrezikut;
- Zgjerimin e mundësive për të monitoruar rreziqet emergjente;
- Vënia edhe më tepër në funksion të impaktit konkret në arritjen e objektivave të Ndërmarrjes;
- Uljen e kostove, duke e ngritur nivelin e përfomancës.

### VI. Zbatimi i planit vjetor në bazë të aktiviteteve të planifikuara

Plani i auditimit për vitin **2021** është realizuar në tërësi, sipas planëprogramit të paraparë:

#### Përzgjedhja e njësive audituese

Departamentet, zyrat dhe sektorët e audituar, janë përzgjedhur në bazë të nivelit të përgjegjësisë, kompleksitetit, rriskut, natyrës së vëllimit të aktiviteteve, për të cilat Menaxhmenti Ekzekutiv duhet të veprojë në mbështetje të plotë për implementimin apo zvogëlimin e vrojtimeve.




Figura 14

Planifikimi dhe realizimi i auditimeve gjatë vitit 2021

Burimet e auditimit janë menaxhuar me eficencë dhe në funksion të realizimit të planit vjetor.

## VII. Treguesit e përformancës së auditimeve për vitet 2018 deri 2021

Duke marrë për bazë treguesit e përfomancës së auditimeve, veçanërisht të atyre më specifike, rezulton se ndër vite kemi ndryshime të rekomandimeve. Numri i rekomandimeve ka një lëvizje nga 57 rekomandime në vitin 2018 në 71 rekomandime në vitin 2019 dhe nga 62 rekomandime në vitin 2020 në 77 rekomandime në vitin 2021.




Figura 15 Treguesit e auditimeve / rekomandimeve, për periudhën 2018 -2021

Rekomandimet e dhëna i kemi bazuar në natyrën e vrojtimeve, që mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, evitimin e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve, ruajtjen e pasurisë publike etj.

Gjatë auditimit, i kemi ekzaminuar dhe testuar çështjet me ndikim më të lartë, ku në vazhdimësi të procesit të auditimit janë dhënë rekomandime të cilat janë prezantuar në raportet e auditimit. Varësisht nga natyra dhe kërkesa e personelit janë dhënë edhe këshilla të ndryshme gojore.

Nr.	Departamentet, Zyrat	Rekomandimet për vitin 2021
1.	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	27
2.	Zyra për Planifikim Afatgjatë	8
3.	Zyra për Cilësi dhe Politika	7
4.	Zyra Ligjore	6
5.	Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun	9
6.	Departamenti i Prokurimit	20
	<b>Totali</b>	<b>77</b>

Tabela 14

Departamentet, zyrat e audituara dhe numri i rekomandimeve

**Tabela 1. Departamentet, zyrat e audituara dhe numri i rekomandimeve**

Raportet paraqesin nivelin kyç për adresimin e këshillave në ngritjen e nivelit të përmirësimit për dobësitet, gabimet apo paqartësitë të cilat ekzistojnë në Ndërmarrje. Në përgjithësi auditimet kanë reflektuar pozitivisht në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të ndërmarrjes.

Në përgjithësi subjektet e audituara kanë treguar progres në përmirësimin e sistemit të mjedisit të kontrollit, zbatimin e procedurave, ligjeve dhe rregullave përkatëse. Gjithashtu kanë treguar një bashkëpunim të mirë, duke i marrë për bazë këshillat dhe rekomandimet të cilat do të janë gjithmonë në funksion të optimizimit të vlerës në Ndërmarrje.

Raportimi i të gjeturave në kohë dhe cilësi është një mbështetje për ndërmarrjen që të sigurojë llogaridhënie në cilësinë e menaxhimit dhe funksionimit të saj.




Figura 16

Treguesit e rekomandimeve për vitin 2021

Gjatë vitit auditues 2021 të gjitha Departamentet dhe zyrat tjera i kanë përgatitur planet për veprim për implementimin e rekomandimeve dhe janë aplikuar testimet matëse për shkallën e zbatueshmërisë së implementimit të tyre, të cilat janë të prezantuara në tabelën nr. 15

### VIII. Niveli i implementimit të rekomandimeve

Një nga sfidat e konsideruara është vlerësimi për implementimin e rekomandimeve. Ky fakt e rrit cilësinë e tyre dhe e forcon bashkëpunimin me njësitë e audituara, që ato të ndërmarrin veprime të konsiderueshme në implementimin e gjetjeve në lidhje me gabimet e ndodhura dhe përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Këtë e bënë duke u përpjekur që:

- T'i implementoj rekomandimet dhe të rrisë dobinë e tyre për njësitë e audituara;



## RAPORT VJETOR 2021

**DT-FI-010**

ver. 1.0

faze 90 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

- Të rrisë bashkëpunimin me njësitë e audituara, me synimin e rënies dakord që ato të implementohen;
- Të kërkoj respektimin e afatit për veprimet e marra ndaj njësisë nga menaxhmenti për implementimin e rekomandimeve;
- Të kërkohet përgjegjësi ndaj personave përgjegjës për mos implementimin e rekomandimeve.

Për të parë nivelin e implementimit të rekomandimeve dhe për tu siguar se njësitë kanë ndërmarrë veprime konkrete korrigjuese në implementimin e rekomandimeve janë aplikuar testime matëse.,

Të gjitha rekomandimet e prezantuara i përkasin natyrës për forcimin e kontrollit të brendshëm, nivelin e përgjegjësisë, eliminimin e gabimeve apo paqartësive në funksion të përmirësimit të sistemit.

Nr.	Departamentet, Zyrat	Plani për implementim	Implementim i tërësishëm sipas raportit	Implementimi në Proces	Nuk janë implementuar, vijojnë për tu implemtuar në 2022
1.	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	I përgatitur	70 %	10 %	20 %
2.	Zyra për Planifikim Afatgjatë	I përgatitur	70 %	20 %	10 %
3.	Zyra për Cilësi dhe Politika	I përgatitur	80 %	10 %	10 %
4.	Zyra Ligjore	I përgatitur	60 %	10 %	30 %
5.	Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun	I përgatitur	75 %	15 %	10 %
6.	Departamenti i Prokurimit	I përgatitur	60 %	30 %	10 %

Tabela 15

Gjendja e implementimit të rekomandimeve për vitin 2021

### IX. Cilësia e raportimit të auditimit

Cilësia e raportimit të auditimit bazohet në respektimin e standartëve të raportimit për auditim të brendshëm, me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, konçize, të sakta, të bazuara në fakte dhe mbi të gjitha të vlefshme për ta ndihmuar Ndërmarrjen në përmirësimin e punës dhe rritjen e eficencës së aktiviteteve në Ndërmarrje.

Rritja e cilësisë së raportimit, do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorimin sistematik.

Raportet janë hartuar sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe programeve dhe udhërrëfyesve tjerë specifik. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përbajtjes, kohës, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditues.

Mbledhja e fundit e mbajtur e komisionit të auditimit është bërë me datë 15 gusht 2017.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 91 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

## Raportet e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Bazuar në kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 12 gusht 2021 nr.08-Re 007 drejtuar Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për auditimin e këtyre fushave në KOSTT që janë:

Për piken nr.1: Auditimi i vendimeve që kanë të bëjnë me dhënien e pëlqimeve për ndërtim / shfrytëzim të pronës së NP KOSTT sh.a. nga palët e tjera, nga 1 janari 2015.

Për piken nr.2: Auditimi i vendimeve lidhur me strukturën e brendshme organizative dhe vendimeve të ALPEX, dega në Kosovë.

Për pikën nr.3: Auditimi i marrëveshjeve për blerje të energjisë së prodhuar, në mes të NP KOSTT sh.a dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme, lidhur me pagesat / tarifit nxitëse.

Bordi i Ndërmarrjes Publike KOSTT dhe menaxhmenti ekzekutiv i kanë pranuar raportet nga Zyra Kombëtare e Auditimit, janë pajtuar me të gjeturat e konstatuar dhe kanë shprehur gatishmëri të plotë për ndërmarrjen e veprimeve për implementimin e rekomandimeve.

## 11. Burimet njerezore

### 11.1. Politika e personelit në KOSTT

KOSTT posedon me kuadrin e plotë të personelit të nevojshëm për të kryer në mënyrë efektive të gjitha obligimet e saj, si nga aspekti i kompanisë së themeluar sipas ligjit për shoqëritë tregtare, ashtu edhe për nga aspekti i afarizmit të rregulluar. Zyra e Rregulatorit të Energjisë, me rastin e kryerjes së rishikimeve të tarifave shumëvjeçare, shqyrton numrin e punëtorëve të secilit biznes të ndarë, dhe i ndanë funksionet qendrore dhe mbështetëse të entitetit të korporatës për secilin biznes të licencuar për t'u siguruar që biznesi disponon me burime njerezore adekuate.

KOSTT sh.a. si një tërësi, dhe aktiviteti i operatorit të sistemit të transmetimit, si aktivitetet i ndarë dhe funksion i rregulluar veçmas, disponon të gjitha burimet të tjera teknike të nevojshme për kryerjen e plotë dhe efektive të detyrave të tij, të tillë si sistemet e teknologjisë së informacionit të përgjithshëm, duke përfshirë serverët dhe internetin, si dhe teknologjinë e kontrollit të sistemit përfshirë blerjen e funksioneve të kontrollit të sistemit. KOSTT ka një strukturë të trajnimeve operacionale, duke përfshirë një dhomë simulimi për stafin e operimit të sistemit. Duke përdorur këto objekte, KOSTT-i zhvillon trajnime për dispeçer plotësisht në përputhje me kërkesat e ENTSO-E. Dispeçeret e OST-së gjithashtu përfitojnë nga trajnimi përmes një program shkëmbimi me qendrat e tjera fqinje për dispeçer. Forma të tjera jo të specializuara të trajnimeve mund të merren në treg në varësi të nevojave të veçanta të vlerësuara.

	<b>RAPORT VJETOR 2021</b>	<b>DT-FI-010</b>
	ver. 1.0	faqe 92 nga 170
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli	

Funksionimi operativ i KOSTT kërkon që një numër i vendeve të punës të mbulohen 24 orë / 7 ditë në javë, siç janë dispeçerët e Qendrës Dispeçerike Nacionale, operatorët në nënstacioneve, dhe një pjesë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

#### **11.1.1. Struktura kualifikuese**

Struktura e përgatitjes profesionale në KOSTT dallon në përgjithësi nga tërë sektori i energjisë elektrike. KOSTT duhet të posedoj personel që duhet të mbulojnë fushat e tërë sektorit energjetik të një shteti. Siç edhe është e ditur KOSTT është përgjegjës për:

- Operim, zhvillim dhe mirëmbajtje të Sistemit ku kerkohen ekspert me nivel të lartë të përgatitjes profesionale sipas kërkesave Evropiane
- Operim të Tregut të energjisë elektrike, strategji të zhvillimit të tregut, zbatim dhe hartim të legjislacionit përkatës, strategji të zhvillimit të sektorit të energjisë, etj.

KOSTT ka arritur një nivel të lartë në ngritjen e cilësisë së kompanisë, parametrave teknik dhe financiar, reputacion në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe krejt kjo është rezultat i personelit të kualifikuar në nivel të lartë. Si rezultat i kësaj KOSTT ka arritur te siguroj financim të projekteve dhe donacione nga institucionet kredibile financiare ndërkombëtare si KFW, BERZH, Komisioni Evropian etj.

Financimet në formë të donacioneve janë investuar në ngritjen e kapaciteteve të rrjetit të transmetimit, në të kundërtën këto investime do të mbuloheshin nga tarifat e konsumatorëve.

Në periudhë 2018-2022, aktivitetet KOSTT-it do të rriten si pasojë e aktivitetave të shtuara për:

- Hapjen e Tregut
- Shitblerjen dhe menaxhimin e fondit te energjisë nga BRE
- Implementimin e Mekanizmit Balancues
- Implementimin e kërkesave nga ENSTO-E

Në krahasim me kompanitë tjera në sektorin e energjisë në Kosovë KOSTT ka nevoja për një strukturë me të veçantë të personelit, karakteristika të cilat janë paraqitur në vijim:

#### **11.2. Numri i punëtorëve**

Me datën 1 Janar 2021 numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 354, ndërsa me datën 31 dhjetor 2021 numri i të punësuarve është 348. Numri i lejuar i punëtorëve nga ZRRE per KOSTT është 381 punëtorë.

Duhet theksuar se në numrin prej 348 të punësuarve janë edhe 18 punëtorë ti ri, të cilët kanë filluar punën më 15.12.2021, të pranuar me konkurs publik pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në fund të nëntorit 2021.

Aktualisht nuk kemi asnjë të punësuar nga minoritetet, ndërsa kemi tre të punësuar me nevoja të veçanta.



## RAPORT VJETOR 2021

ver. 1.0

DT-FI-010

fazë 93 nga 170

Departamenti Financiar

Sektori: Planifikimi i Buxhetit dhe Kontrolli

Janë pensionuar 15 punëtorë dhe katër punëtor kanë ndërruar jetë, kurse pesë punëtorëve ju ka ndërprerë marrëdhënia e punës.

